

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

**Ekstrakti nga procesverbali, mbledhja e nëntë - IX të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 26.09.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

**Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës:** Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete.

Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Doruntina Jashari, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

**Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës:** Besnik Osmani - Nënkryetar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Mimoza Kolshi - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Ardit Sekiraqa - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Vjosa Kida Hyseni - Drejtore e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

**Të tjerë:** Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet dhe Lindita Dervisholli/Prebreza - Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

#### REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 05.07.2024 dhe 31.07.2024.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e buxhetit të planifikuar të komunës për vitin 2025 dhe vlerësimeve për vitet 2026 dhe 2027.
4. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Këshillin Bashkiak të Bashkisë së Tiranës.
5. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.
6. Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar të komunës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.
7. Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2023.
8. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.

9. Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026.
10. Propozim për shpalljen me interes publik dhe fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e objektit të Xhamisë në Fushë-Kosovë.
11. Rishqyrtimi i vendimit Nr. 104, të datës 02.08.2024, sipas shkresës 020-7/10 të datës 15.08.2024.
12. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme. Po ashtu sqaroi se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa tek pika lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e objektit të Xhamisë, kolegu ynë z. Hasan Ismajli, e ka dorëzuar një kërkesë, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, që tek ky propozim të shqyrtohet, edhe propozimi i tyre që të jepet një pjesë e tokës aty për vendosjen shtatores së presidentit 'Ibrahim Rugova', të cilën duhet ta shqyrtojmë tek e njëjta pikë. Hap debatin për pikat e rendit të ditës.

**Hasan Ismajli:** Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Tek pika e gjashtë për dhënien në shfrytëzim të një parcele, fleta poseduese dhe kopja e planit nuk janë në përputhje njëra me tjetrën, atëherë unë kërkoj që deri sa të mbërrijmë tek kjo pikë zyrtari apo Drejtori, këto dokumente me na i sjellë të nënshkruar dhe të vulosura nga personi përgjegjës, që i ka lëshuar, sepse as nuk ka emër kush e ka lëshuar dhe as nuk ka vulë, dokumenti publik që na është dorëzuar neve anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kam edhe një kërkesë tek rendi i ditës, që pas përfundimit të pikës së tretë të hyn në pikën e katërt 'Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e vizitës në Bashkinë e Tiranës', për arsye të procedurave administrative në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit, sepse nuk e di, a do mundemi ta përfundojmë mbledhjen sot, meqë i kemi dymbëdhjetë pika të rëndësishme në shqyrtim. Tani pas qartësimeve lidhur me procedurat, e qes në votim 'Propozimin që të hyjë në shqyrtim si pikë e katërt pas planifikimit të buxhetit 'Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në Këshillin Bashkiak të Bashkisë së Tiranës'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me votim unanim e aprovon propozimin që 'Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në Këshillin Bashkiak të Bashkisë së Tiranës', të jetë pika e katërt e rendit të ditës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës, me ndryshimin e aprovuar tani.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës së propozuar për shqyrtim në mbledhjen e sotme, me ndryshimin e cekur më lartë.

**Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 05.07.2024 dhe 31.07.2024.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Tani i kemi për shqyrtim dhe miratim dy ekstrakte të procesverbaleve, nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 05.07.2024 dhe 31.07.2024, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet e juaja.

**Durim Hajra:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, duhet ta respektoni Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren e Kuvendit, mikrofonat nuk funksionojnë, po shihen disa ndryshime të vogla, të cilat realisht secili prej asamblistëve këtu mundet edhe me mohuar, por të bien në sy çdo ndryshim i vogël që ndodh, e ju e keni bërë në sallën e Kuvendit të Komunës si: ndriçimi, karrikat, perdet, e keni dëshmuar që interesi i këtij Ekzekutivi të Komunës, nuk është për me rritë transparencën dhe është mesazh i qartë që këtu nuk ka interes për këtë punë. Ju lutem analizoni kërkesën tonë, që së paku me u funksionuar zërimi, sepse për këto arsye ne jemi kundër votimit të kësaj pike.

**Migjen Kolshi:** Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Në mbledhjen e datës 31.07.2024, tek pika e dytë, pyetje dhe përgjigje parlamentare, pash një shkrim shumë të gjatë dhe ky shkrim nuk është i imi, besoj se është bërë gabim teknik, në faqen numër tetë. Sa i përket votimit dihet për arsye të mos publikimit, ne nuk e votojmë ekstraktet e procesverbaleve .

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i qiti në votim për aprovim 'Ekstraktet e Procesverbaleve nga dy mbledhjet e kaluara, me ndryshimin te cilin e ceku anëtari i Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi, për mbledhjen e datës 31.07.2024.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', nëntë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave i aprovoi 'Ekstraktet e Procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtur më datën 05.07.2024 dhe 31.07.2024, me ndryshimin e cekur nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi, për mbledhjen e datës 31.07.2024.

**Pika dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrojnë pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës nëse kanë.

**Durim Hajra:** Unë kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit për objektin e ri të shkollës 'Mihal Grameno', ku ka pasur ankesa prej disa prindërve, të cilët janë shkuar me pastruar objektin e shkollës, për arsye se nuk ka qenë i gatshëm për fillimin e procesit mësimorë dhe për arsye të vonesën së fillimit të procesit mësimorë, pyetja është për drejtorin, se a është e vërtetë dhe s'po kuptoj pse prindërit me shkua atje me kryer punën që nuk ju takon, sepse është personi përgjegjës i cili merr pagë për këtë punë. A keni ndërmarrë diçka për rastin e nxënësit në Shkollën e Mesme të Lartë 'Hivzi Sylejmani', që është me nevoja të veçanta dhe ka mungesë tualeti në shkollë, që i plotëson kërkesat për personat me nevoja të veçanta, nëse po është mirë me na njoftuar, sepse keni dhënë premtim. Për Drejtorinë e Inspektoratit, tani drejtorin nuk po e shoh, qe një kohë të gjatë dhe është drejtoria, e cila ka më së shumti punë dhe kryen masë pakti punë, kjo po tregon edhe me raportin e shpenzimeve që kemi me pas tani në shqyrtim, mirëpo po shihet edhe me punën në teren. Pyetja ka qenë e ripërsëritur nga ana jonë, për arsye se ankesat dhe gjendja në teren është e njëjta, pse nuk po intervenohet mi liruar hapësirat publike dhe të përbashkëta të cilat janë uzurpuar, sidomos në pjesën e qytetit. Drejtorin e Shërbimeve Publike, meqenëse nuk është prezentë, është

mirë që pyetjet e parashtruara nga ne t'i merr nga procesverbali, në rrugën 'Tahir Zemaj' është ndërhyrë dhe është prishur asfaltimi dhe nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme asfaltimi, po shkakton problem dhe dëme tek qytetarët. Për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ne realisht e kemi parë se politikisht është përdorë dhe është reklamuar prej drejtorit dhe zyrtarëve komunal, investim në stadiumin 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë, pyetja është, a keni zhvilluar procedura të tenderimit për investimin e projektit të stadiumit 'Ekrem Grajçevci', nëse po ku janë zhvilluar ato procedura, sepse në sistem të 'e-prokurim', nuk ka ndonjë kontratë publike e cila është dhënë për këtë investim, e nëse e keni bërë në forma tjera është mirë me na njoftuar. Nëse kemi investua me para publike dhe prej taksapaguesve të Fushë Kosovës, është mirë me pa ne se si janë zhvilluar këto procedura dhe nëse nuk ka procedura të tenderimit, i bie që është investuar komplet nga Federate e Futbollit të Kosovës, e jo nga Komuna e Fushë- Kosovës.

**Mirsad Qyqalla:** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, meqenëse është një mbledhje me shumë pika të rendit të ditës, unë po mundohem të jem sa më i shkurt në pyetje. Drejtoria e Inspektoratit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të cilat kanë punë më së shumti dhe të dy drejtorët nuk janë prezent në mbledhje. Sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, dua të pyes për 'Rregulloren për varrezat', pse nuk po zbatohet, e cila vitin e kaluar është miratuar dhe nuk po fillon së zbatuari. Pyetjen tjetër e kam për ndriçimin publik, në mbledhjen e kaluar drejtori më ka premtuar, që në fund të gushtit ka me qenë prezent në 'Bardh të Madh', ne jemi në fund të shtatorit dhe unë nuk po shoh ndonjë ndryshim. Sa i përket Drejtorisë së Inspektoratit, hapësirat publike pse nuk po i lirojnë? Pyetjen tjetër e kam për Drejtorin e Infrastrukturës, një qytetar nga fshati Pomozotin, thotë që një kompani, që ka marrë një tenderë për largimin e mbeturinave në Fushë-Kosovë, mbeturinat te cilat i marrin, i hedhin në lum dhe në komunikim me personin në fjalë, që mbeturinat i hidhte në lum, na tha që z. Bardhyl Koiçiçi na ka thënë që t'i hedhim mbeturinat në lum. Nuk po e di tani sa është e vërtetë kjo punë, mirëpo një kompani e cila merr tenderë për largimin e mbeturinave dhe i hedh në lum, nuk është në rregull, mendoi se këtu po bëhet një dëm i dyfishtë, sepse kjo komunë prapë ka me angazhuar një kompani tjetër për largimin e tyre. Një kërkesë e kam për ju z. Bardhyl Koiçiçi, për pllakën e heroit 'Daut Pllana' në fshatin Bardh i Madh, ku familjarët e tij thonë që kemi bërë kërkesë, për pengesën të cilën u vendos dhe ne të cilën prapë tubohet uji dhe ka filluar rrënimi i saj, kjo vazhdon kështu për dy vite, ndërsa ne vazhdimisht kemi bërë kërkesë për largimin e sajë, kjo familje më është lutur që prapë të bëjë kërkesë për ta eliminuar këtë problem. Pyetjen e fundit e kam për mbjelljen e drunjëve, ku është bërë hapja e gropave për vendosjen e drunjëve, që një muaj dhe ato po mbesin të hapura dhe qytetarët po kanë shumë vështirësi, unë s'po kuptoj pse i lejohet një kompanie, kjo mënyrë e zbatimit të tenderit, ku një qytet e kalon në vështirësi për arsye të një interesi të dikujt, i cili nuk dëshiron të angazhoi më shumë punëtorë dhe ta përfundoi punën brenda dy tri ditëve.

**Hasan Ismaili:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, po ashtu edhe për sekretarin e degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në Fushë-Kosovë, i cili është prezentë sot në këtë mbledhje. Pyetja ime është për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i nderuar drejtor keni subvencionua një qytetar në 'Bardh të Madh, unë dua ta di mënyrën, se si i keni dhënë këto të holla me cilin Ligj, Rregullore apo Udhëzim Administrativ keni punuar, nëse keni mundësi me na treguar. Pyetja për Drejtoreshën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pse nuk po e publikoni listën e përfituesve të granteve të cilat i keni ndarë.

**Drejtoresha e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:** Listat janë të publikuara në ëeb-faqen zyrtare të komunës.

**Hasan Ismajli:** Unë nuk i kam parë edhe pse shumë herë më kanë bllokuar mua dhe nuk kam qasje në ueb-faqen zyrtare të komunës. Pyetja tjetër e kam për Drejtorinë e Kadastrit, është kërkesë e imja dhe shumë të tjerëve, publikimi i pronave komunale, dua ta di arsyen pse nuk publikohen këto prona komunale, sepse neve na duhen, për shkak që jemi afër fushatës zgjedhore dhe kush do që është kandidat për Kryetar Komune, i duhen për programin e tij. Unë dua ta di, cili është problemi që ju nuk na i sjellni këto prona. Tek Drejtoria e Arsimit dua të pyes, a'ka shkolla e re pranim teknik dhe a është e kyçur rryma, sepse sipas informatave që unë i kam nuk është. Dua të pyes Drejtorin e Infrastrukturës, cili ishte qëllimi i vizitës në Francë, nëse keni mundësi me na treguar, çfarë dobie ka komuna nga kjo vizitë dhe çka përfiton komuna nga kjo në të ardhmen, a do të ketë ndonjë projekt dhe nëse po cili do jetë. Meqenëse Nënkryetari i Komunës nuk është këtu, dua të bëjë një pyetje ligjërishit zyrtarit të Kuvendit. A ka të drejtë një anëtarë i Kuvendit, me qenë menaxher i një projekti, sepse ne kur kemi kërkuar të jem vëzhgues në komisione për ndarjen e subvencioneve dhe në konkurse, na është thënë, nuk keni të drejtë sepse jeni legjislativ, ndërsa Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete, ka të drejtë me qenë udhëheqës dhe i ndërron titulli i vendit të punës në Zyrtar për Komunitete. Ndërsa unë e di se Zyrtare për Komunitete është znj. Sladjana Lazic, ata të cilët i'a kanë emërtimin e pozitës së punës kanë bërë shkelje. Po ashtu pyetjen tjetër, a ka të drejtë që i njëjti person me nënshkruar një marrëveshje komuna me një OJQ, për bashkëfinancim për blerjen e mjeteve shkollore për nxënësit e të gjitha komuniteteve. Unë nuk jam kundër komuniteteve, mirëpo dua ta di, a ka të drejtë ligjore? Një pyetje tjetër e kam për Nënkryetarin e Komunës, por meqenëse nuk është prezentë, nëse ka mundësi të përgjigjet dikush nga zyrtarët e financave. Kur do i procedoni nëntë qind mijë euro për të cilat është marrë vendimi në tetor të vitit 2020, ku Kuvendi i Komunës i ka ndarë ndihmë për personat të cilët janë prekur nga Covid - 19 në vitin 2020, një propozim i cili ka ardhur nga Kryetari i Komunës për ndihmë nga 100€ dhe në vitin tjetër, janë ndarë 900.000.00€, po ashtu kanë qenë kodet prej të cilave, munden mi marrë këto mjete financiare, pyes, kur do ta realizoni këtë vendim, nëse nuk e keni ndërmend me realizuar, dua ta di ku kanë shkuar ato para.

**Shpend Bardiqi:** Përsëritet për të gjithë, unë i kam dy pyetje, po filloj me pyetjen e parë, a ka pasur thirrje publike për klubet për OJQ-të, sepse dua ta di, si është bërë përzgjedhja e klubit 'Kosovari', nëse nuk ka pasur thirrje publike me çfarë të drejte lidh 'Komuna marrëveshje apo memorandum bashkëpunimi', ku implikohen edhe mbulimi i shpenzimeve financiare për blerjen e aseteve të ndryshme për klube. Unë edhe mbledhjen e kaluar, e kam cekur që për arsye të një fotografie, një klubi ju ka ndaluar transporti. Pyetja e dytë e kam për Drejtorin e Inspektoratit, ku unë personalisht, nuk e kam parë, që një kohë të gjatë drejtorin dhe me thënë të drejtën jam pak i brengosur për të, sepse në teren nuk shihet asnjëherë, e në mbledhje nganjëherë u takoheshim por tani as këtu nuk po vjen. Deshta ta pyes, se a ka dëgjuar nga një Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit më herët, i cili thotë se asnjë prej këtyre shenjave, që janë për parkingje të rezervuara në Komunën e Fushë-Kosovës, asnjë nuk ka leje prej komunës dhe të gjitha janë të uzurpuara, këtë mundemi me dëshmuar me fakte. Dua ta di cili është problemi, nuk don apo nuk guxon t'i liroi këto hapësira publike.

**Doruntina Jashari:** Përshëndetje për të gjithë. Unë kam një pyetje për Drejtorin e Infrastrukturës për rrugën 'Hajrulla Zymi' në Fushë-Kosovë, e cila rrugë ka filluar me u rregulluar dhe pyetja ime është, a keni menduar për një zgjidhje alternative për banorët të cilët sot kishin mbetur të bllokuar.

**Dardane Sogojeva Shala:** Përshëndetje për të gjithë. Po filloj me pyetje për Drejtorin e Infrastrukturës, ku dua të ndërlihem me pyetjen e parafolëses, a kishte qenë më mirë me mbyll komplet rrugën 'Hajrullah Zymi', deri sa të përfundojnë punimet, sepse banorët kanë mbetur në kushte jo të mira, po ashtu të rritet numri i punëtorëve, që të përfundohet më shpejtë ajo rrugë, sepse qarkullimi është shumë i madh në atë pjesë. Pyetjen tjetër e kam për Drejtorinë e Arsimit, banorët e fshatit 'Bardh i Vogël', janë duke bartur fëmijët me mjete vetjake në shkollën e fshatit Sllatinë e Madhe, pyes kur do bëhet transferimi i mjeteve financiare për këtë problem. Po ashtu dua të pyes, pse në shkollën 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë tualetet janë pa dyer dhe kur do të vendosen dyert?

**Aida Alimi:** Përshëndetje për të gjithë. Unë kërkoj që Komisioni për emërimin e rrugëve, të plotësohet për arsye se kemi disa kërkesa dhe duhet të shtohen disa emra të rrugëve, e të cilat duhet të votohen në Kuvendin e Komunës, sepse mbi dhjetë rrugë kanë mbetur pa adresa. Kjo kërkesë është imediate dhe urgjente, që të plotësohet Komisioni për emërimin e rrugëve. Pyetjen tjetër dua ta parashtroi për bllokimin e rrugës 'Gjergj Fishta' tek kompleksi 'Linda 4 - 5', nuk e di me çfarë të drejte qytetarët, e kanë bllokuar komplet rrugën, kjo pronë është pronë shtetërore, e cila është bllokuar nga qytetarët, kërkoj që të dilni në teren dhe ta shihni atë rrugë. Po ashtu siç e dimë që KEDS-i është kompetent për shtyllat elektrike, por njëkohësisht edhe komuna duhet me dalur në teren, edhe me pa vetë situatën, sepse gjendja në rrugën 'Gjergj Fishta', është jo e mirë. Kërkoj nga Drejtoria e Inspektoratit, që të del në teren, sepse sidomos në mbrëmje rrugët janë të pa kalueshme për shkak të automjeteve të parkuara në trotuar, ku këmbësorëve po ju vështirësohet lëvizja.

**Migjen Kolshi:** Përshëndetje për të gjithë. Pyetja ime është për Drejtorin e Arsimit lidhur me shkollën e re - Aneksin 3, të cilën Drejtori i Arsimit e prezantoi shumë mirë, mirëpo realiteti është krejt tjetër, i nderuar drejtor që dy javë nuk ka rrymë në shkollë, tash ftohet koha dhe nxemjet atje nuk punojnë, nuk ka ujë të ngrohtë për pastrimin e dysHEMEVE, po ashtu që dy javë ka filluar procesi mësimorë dhe asgjë nuk është ndërmarrë për oborrin e shkollës, unë pash që në buxhetin e vitit 2025, i keni paraparë një shumë të mjeteve financiare prej: 25,000.00€, unë pyes, a do të mbetet gjendja e oborrit të shkollës deri në vitin 2025 kështu, apo do të ndër mirrët këtë vit diçka sepse në këto raste, unë mendoj se janë kontratat një burimore, që besoj se lejohen, sepse janë me urgjencë. Ndërsa sa i përket hapësirës së shkollës brenda, nuk e di kush e ka bërë projektin, mirëpo klasat janë shumë të vogla, personi i cili e ka bërë projektin nuk e ka menduar se në Fushë-Kosovë, në një klasë janë 30 - 35 nxënës. I nderuar Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, sa i përket ndriçimit publik në fshatin Harilaç 80 - 85% e ndriçimit nuk punon, pyetja ime është kur keni me filluar punën e ndriçimit publik në fshatin Harilaç. Kam edhe një pyetje për Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, të cilën e kam bërë shumë herë dhe asnjëherë nuk kam marrë përgjigje, a është konflikt interesi që Kryetari i nëndegës së fshatit Bardh i Madh, me marrë subvencion prej Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit? Unë e kam edhe një pyetje tjetër për Drejtorin e Arsimit, a është ndërmarrë ndonjë masë për Drejtorin e shkollës së fshatit Sllatinë e Madhe, a është thirrur ai në Komision Disiplinor, ku të gjithë ne e dijim, se ky drejtor e ka dhunuar një fëmijë fizikisht.



**Vlonjat Hasani:** Përshëndetje për të gjithë. Unë çdo herë po filloj me çështjen e rrugës 'Lumi' në fshatin 'Miradi e Epërme', i cili fatëkeqësisht edhe në planifikim të buxhetit, ishte veç i përmendur për rrugën, por jo për problemin e kanalizimit, që e ka kjo rrugë dhe kaluan dy vite dhe nuk ka asgjë për rregullimin e kësaj rruge, ne deri sa të shohim një vendim konkret kemi me përmend këtë rrugë. Po ashtu u përmend edhe nga parafolësit çështja e rrugës 'Hajrullah Zymi' në qytet, në fillim qytetarëve u është thënë se rruga ka me qenë 8 metër e gjerë dhe ashtu ka filluar puna, e pastaj ka ardhur një përfundim nga mbikëqyrësit të cilët ju kanë thënë banorëve të asaj rruge, se rruga do të jetë e gjerë pesë metra, ky problem është duke i shqetësuar banorët, sepse ata të cilët po uzurpojnë hapësirat publike, nuk po i pengon askush, rruga po ngushtohet, pjesa e uzurpuar nuk po i pengon askujt dhe kjo nuk po i shërben komunitetit dhe qytetarëve, kështu që me këtë problem keni me u ballafaquar edhe ju në implementim e sipër të atij problemi, ky është një shqetësim dhe besoi, se dikush duhet me dhënë sqarim për këtë problem. Problemi i njëjtë është edhe në rrugën 'Idriz Breznica' në Fushë-Kosovë. Për Drejtorinë e Arsimit, kemi kërkesa, po thuajse të gjitha shkollat kanë nevojë për mirëmbajtje të oborreve të shkollave, e që kishte qenë mirë para se të keqësohet moti, këto oborre të rregullohen, këtu është dashur që të rregullohen para se të filloi procesi mësimorë. Kishte qenë mirë me ndarë buxhet, ose me marrë një vendim që nxënësve të ju dërgohet material shkollor, për t'iu lehtësuar mësimdhënësve procesin mësimorë, sepse po detyrohen mësimdhënësit, me kërkuar buxhet prej prindërve, që t'i realizojnë programet e tyre, në zhvillimin e procesit mësimorë. Në hyrje të rrugës 'Bedri Pejani' në Fushë-Kosovë, këtu afër gjykatës është bllokuar rruga me disa kontejnerë dhe banorëve, po ju shkakton probleme në qarkullime. Dy pyetje i kam edhe për Nënkrjetarin e Komunës, mirëpo ai nuk po vjen në mbledhje, me siguri është duke i ikur përgjegjësive ose pyetjeve. Tek çështja e pronave të varrezave në fshatin 'Miradi të Epërme', si është e mundur me u marrë një vendim, për përcaktim të një pjese të varrezave dhe mu rrethuar varrezat e reja, kur ende nuk është caktuar pjesa për varrezat e reja, kjo punë është pak e çuditshme. Unë nuk di si ta quajmë Nënkrjetarin e Komunës, i cili del dhe ndikon drejt për drejt, ku një qytetar i Komunës së Fushë-Kosovës, ka mbetur pa punë, për arsye të kërkesës të Nënkrjetarit të Komunës. Këtij qytetari ju ka ndërprerë kontrata e punës, për arsye të një kërkesë që ka ardhur prej Nënkrjetarit të Komunës z. Besnik Osmani. Punëtori z. Xhemajl Berisha, ka qenë i angazhuar në Demokraci Plus, i cili e ka pasur rajonin e Fushë-Kosovës, për mbikëqyrjen dhe bashkëpunim, por z. Besnik Osmani shkon direkt tek zyrtarët e Demokracisë Plus dhe ju thotë, ky person është i papërshtatshëm me punuar me ne dhe nëse nuk largohet, bashkëpunimin e ndërprejmë dhe normal ata i'a kanë ndërprerë kontratën, këtij djali të ri të shoqërisë sonë.

**Fisnik Sllamniku:** Përshëndetje për të gjithë. Kam disa kërkesa nga Këshilli i mësimdhënësve, tek Drejtoria e Arsimit, që të pajisemi me lektura shkollore prej klasës 1 - 9, sepse janë vjetërsuar. Kërkesa tjetër e shkollës 'Vëllezërit Frashëri', është që të ju sigurohet një psikolog për tri paralele, po ashtu tek çështja e orarit në shkollën e fshatit 'Miradi të Epërme', atje mësimi fillon në orën 7:30h të mëngjesit për arsye të orareve të autobusëve, kanë problem mësimdhënësit dhe nëse është mundësia me ndërruar orarin dhe me filluar prej orës 8:00h mëngjesit. Dua ta falënderoj Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, në fshatin Vragoli është rregulluar komplet ndriçimi dhe është duke funksionuar jashtëzakonisht mirë. Pastrimi i mbikalimit është në rregull.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Kam një pyetje për Drejtorin e Arsimit, në shkollën e fshatit Bardh i Madh, kemi një fëmijë problematikë dhe besoi që keni ndërmarrë masa me atë problem që është shfaqur në atë shkollë. Kisha propozuar me shkuar me vizituar atë shkollë, me biseduar me

mësimdhënësit, sepse ky problem është për disa vite. Kujdestarja e këtij fëmiju nga një person kërcënohet, që ka biseduar me ju që është i gatshëm me shkarkuar dhe me larguar në shtëpi kujdestaren. Unë mendoj që ju jeni të informuar dhe me na dhënë një përgjigje zyrtare.

**Drejtori i Arsimit:** Përshëndetje për të gjithë. Po filloi me përgjigjen e kolegut z. Durim Hajra, sa i përket Aneks - 3, pastrimi i objektit është bërë nga prindërit. Kompani e cila është duke e ndërtuar objektin shkollorë, punimet nuk i ka përfunduar ende dhe pastrimi është bërë nga një kompani, të cilën e kanë nënkontraktuar kompania ekzistuese, unë nuk kam asnjë informacion që janë ftuar prindërit dhe kanë bërë pastrimin e objektit shkollorë. Sa i përket tualeti në gjimnaz, dje i kam filluar kontaktet me një kompani, e cila ka premtuar se shumë shpejt do ta rregulloi atë tualet. Deri në mbledhjen e ardhshme, nëse secila kompani që ka marr detyrë nuk i përfundon detyrat e veta, kam mi përfunduar unë vetë. Sa i përket pyetjes së z. Hasan Ismajli, pranimi teknik i objekteve tani nuk bëhet, rryma nuk është e lidhur, gjatë vikendit do të vendoset kabloja, e cila e zgjedh problemin e rrymës në shkollë. Tani këtu znj. Dardane Sogojeva Shala, i ka parashtruar dy pyetje, subvencionimi i nxënësve në fshatin Bardh i Vogël dhe gjatë javës së ardhshme, do të veprojmë në mënyrën e njëjtë, siç kemi vepruar vitin e kaluar, do t'i subvencionojmë prindërit dhe ata do ta bëjnë zgjedhjen e transportit për fëmijët e tyre. Tualetet pa dyer në shkollën 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë nuk është e vërtetë. Kolegu z. Migjen Kolshi, oborri i shkollës për vitin 2025, është e vërtetë, sepse në para masën ekzistuese, nuk është e paraparë të rregullohet oborri në tërësi oborri i shkollës në rrugën 'Amir Elmazi'. Ne do të mundohemi me rregulluar pjesën e hyrjes këtë vitë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektoratit, kemi bërë shkresë zyrtare që operatori ekonomik i cili është duke e ndërtuar objektin, ai duhet ta bëjë rrethojën e hapësirës punuese të tij. Klasat e vogla, në proporcion me numrin e nxënësve, të cilët kanë qenë në Aneksin - 1 dhe të cilët i kemi zhvendosur, ka qenë e mjaftueshme, mirëpo tani është e vërtetë se numri i nxënësve është më i madh, se që mundën me përballuar ato klasë, por për momentin alternativë tjetër nuk kemi. Në Aneksin - 1 një i kemi nga 25 - 26 nxënës, ndërsa Aneksin - 3 i kemi nga 33 nxënës. Drejtori i shkollës në 'Bajram Curri' në fshatin Sllatinë e Madhe, unë personalisht e kam kontaktuar me Nënkryetarin e Komunës, drejtorin dhe prindin, jemi ulur e kemi biseduar bashkërisht dhe i kemi ndërmarrë masat, të cilat është dashur t'i marrim, kjo është mbyllur me marrëveshje, sepse faji ka qenë i përbashkët. Dua të përgjigjem tek pyetja e z. Vlonjat Hasani, mirëmbajtja e oborreve të shkollës, para disa dite kemi bërë një postim, që u janë ofruar shkollave disa vegla të punës dhe ju kemi dërguar shkollave me filluar me i mirëmbajtur oborret e shkollave. Materiali ndihmës për shkolla, unë pajtohem, por unë e kam një sfidë për mirëmbajtjen e institucioneve edukativo-arsimore dhe jemi duke punuar vazhdimisht, që me ardhur deri tek një kontratë kornizë për zgjidhjen e këtij problemi. Në vitin 2025 kemi planifikuar, furnizimin e bibliotekave të vogla shkollore me ekzemplar të ndryshëm, sipas kërkesave të nxënësve. Udhëzimi Administrativë thotë, aktivitetet jashtë kurrikulare për shkollat fillore caktohen se si drejtohen nga Këshilli Drejtues dhe Këshilli i Prindërve. Fillimi i procesit mësimor në orën tetë, transporti është ky i cili është, unë kam kërkesë që të kthehet ora në katër dhjetë minuta siç ka qenë. Vendimin te cilin e kemi marrë, për ndarjen e shkollave na dërgon në kthimin të orës në 45 minuta në ato shkolla, ku i kemi dy ndërrime, në qendër 'Mihal Grameno' i kemi vetëm dy ndërrime, në Aneksin - 3 i kemi vetëm dy ndërrime, në fshatra ora mësimore është kthyer në 40 minuta në përjashtim të fshatit Sllatinë e Madhe, sepse as mësimdhënësit nuk mundën të mbrijnë në mësim në orën 7:30h, për arsye të transportit publik. Ndërsa qyteti në raport me fshatrat është ndryshe, unë kam me tentuar që orën



me kthye me 45 minuta, edhe nëpër fshatra, sepse ashtu e thotë edhe Udhëzimi Administrative. Në fshatin 'Bardh i Madh', unë e njoh këtë fëmijë, fatëkeqësisht ky fëmijë prindërit i ka të divorcuar, fëmiju jeton në përkujdesjen e hallave të tij. Amanti jeton dhjetë metra larg shkollës dhe veprimet, të cilat i kemi marrë vitin e kaluar, sa i përket nxënësit e kemi zhvendos për një gjysmë vjetor në shkollë tjetër, kjo është praktikë e rregulluar me rregullore, pastaj sipas informatave djali është qetësuar dhe e kemi kthyer prapë në shkollën ku ka qenë. Ne me mundësi, në atë shkollë e kemi dërguar një psikologe, që të mirret jo vetëm me këtë nxënë, por edhe me nxënësit e tjerë. Kryesues të lutem, ai i cili shkon dhe kërcënon mësimdhënës në emrin time, unë kërkoi që ta di urgjentisht, sepse mësimdhënësit në Komunën e Fushë-Kosovës, për të gjithë neve janë ari.

**Migjen Kolshi:** Drejtor unë kontaktova me prindin dhe gjendja tani është ashtu siç thatë ju.

**Hasan Ismajli:** Drejtor ju thatë, nuk bëhet pranimi teknik se gjatë punimeve është menaxheri i projektit dhe gradualisht shkon edhe pranimi teknik. Nëse shkon dhe e viziton atë shkollë, shkallët nuk janë në proporcion me njëra tjetrën. Duke filluar nga për dhësa shkalla e parë është më e naltë se e dyta dhe e treta dhe në katin e tretë në fund, del një edhe më e vogël, këto nuk janë në proporcion. Në qytet oborri i shkollës është vetëm kubëza dhe pyes, çka keni dhënë para për tërfurk në shkollat e qytetit? Drejtor ka qenë një kërkesë që me qenë ora 40 minuta, unë asnjëherë nuk dua që punëtorët e shëndetësisë dhe arsimit mi kritikuar, por në disa shkolla fillore, kur fillon ora mësimore, arsimtarët i keni duke pirë kafë me drejtorin në zyre, pastaj po humbin edhe nja 10 - 15 minuta deri sa të shkojnë në klasë dhe kjo është pa përgjegjësi. Në fund dua ta pyes Zyrtaren e Financave për vendimin e Covid - 19, ku janë shkuar ato para, meqenëse vendimi nuk është ekzekutuar?

**Drejtori për Infrastrukturë:** Dua të ju përgjigjem në pyetjet të cilat i parashtruan për rrugën 'Hajrullah Zymi' në Fushë-Kosovë, momentalisht jemi duke hasur në shumë probleme, mirëpo jemi duke i zgjidhur. Unë ju garantoj se kjo rrugë ka mu bërë e gjerë tetë metra, dy shirita qarkullues dhe një shirit për parking. Gjatësia e kësaj rruge është 540 metra, fillon nga rruga 'Dardania' dhe përfundon tek Hekurudha. Pjesa tjetër prej rrugës 'Nëna Terezë' deri tek 'Dardania', nuk rregullohet këtë vitë, për arsye se ajo ka mu bërë me katër shirita. Punimet i kemi filluar me vonesë dhe ju kisha lutur për mirëkuptim, sepse edhe ne e dimë se po ka vështirësi në qarkullim, afati i përfundimit është 100 ditë dhe përfundon në dhjetor. Për rrugë alternative duhet me na kuptuar. Hedhja e mbeturinave tek ura e fshatit 'Pomozotin', ne kemi pas kërkesë nga një qytetarë mi mbyllur krahët e urës në 'Pomozotin', mi rrafshuar dhe për këtë arsye, ne i kemi dërguar mbetjet e rrugës 'Hajrullah Zymi' atje. Tani kjo punë ka përfunduar.

**Drejtori i Zhvillimit Ekonomik:** Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket vizitës studimore në Francë, ka qenë vizitë e përbashkëtë në mes Komunës së Lipjanit dhe Komunës së Fushë-Kosovës. Këtë iniciativë e ka marrë si kontakti një Agjensioni i Bashkimit Evropian dhe kemi bërë një vizitë në zonën turistike, ne kemi arritur të përfitojmë një master - plane për zhvillimin e turizmit lokal në Komunën e Fushë-Kosovës, ku do të lidhet maja e 'Goleshit' me 'Parkun e Silatinës së Vogël', ku mund të vendosen pajisje të natyrës turistike, ky projekt ka një kosto të madhe dhe na duhet edhe një mandat për realizimin e tij.

**Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e buxhetit të planifikuar të komunës për vitin 2025 dhe vlerësimeve për vitet 2026 dhe 2027.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Ftoj z. Bardhyl Koiçiçi të na e sqaroi 'Propozimin për

shqyrtimin e buxhetit të planifikuar të komunës për vitin 2025 dhe vlerësimeve për vitet 2026 dhe 2027.

**Drejtori i Infrastrukturës:** Përshëndetje për të gjithë, jeni të pajisur të gjithë me materialin e buxhetit për vitin 2025 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2026 dhe 2027. Ne i kemi dorëzuar të gjitha kërkesat tona në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve për planifikimin e buxhetit. Në tabelën të cilën ua kanë shpërndarë, janë realizimet e të hyrave vetjake dhe projeksionet për vitin 2025 që janë 4,289,000.00€, ndërsa me pranimin e qarkores të parë buxhetore, të cilën e kemi marrë nga Ministria e Financave me datën 15 maj, nuk i kanë caktuar kufijtë, aq sa kemi kërkuar 4,289,000.00€, por na i kanë lejuar kufijtë për të hyrat vetjake 3,459,675.00€, me një diferencë prej: 829,325.00€. Në muajin maj kemi pranuar qarkoren, ku janë ndarë kufijtë buxhetor për grantet: granti i përgjithshëm, granti i arsimit, granti i shëndetësisë dhe të hyrave vetjake, diferenca mes këtij viti dhe vitit të ardhshëm është se kemi rritje në grantin e përgjithshëm prej 436,217.00€ apo një rritje prej: 7.67%, grantin e arsimit kemi rritje prej: 252,167.00€ apo rritje 4.77%, grantin e shëndetësisë kemi rritje prej: 28,886.00€ apo 1.66%, ndërsa tek të hyrat vetjake kemi zbritje nga 3,714,607.00€, sa i kemi këtë vite, për vitin e ardhshëm na i kanë lënë 3,459,675.00€ apo zbritja 6.86%. Me marrjen e qarkores së parë buxhetore, ne si Ekzekutiv i Komunës, e kemi shpërndarë qarkoren e brendshme buxhetore tek të gjithë drejtorët e drejtorive, shefat e sektorëve dhe drejtorëve të shkollave, ku kanë pasur afat dy javor për mi plotësuar kërkesat dhe nevojat e tyre për planifikimin buxhetit për vitin 2025 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2026 dhe 2027. Në bazë të kërkesave të tyre, ne e kemi përpiluar Kornizën Afatmesme Buxhetore, të cilën ju e keni aprovuar në muajin qershor. Pas aprovimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, ne i kemi pasur në muajin korrik dy dëgjime publike me qytetarë për vitin 2025, pastaj në muajin gusht i kemi pasur dy dëgjime tjera buxhetore. Me 15 gusht e kemi pranua qarkoren e dytë buxhetore nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ku nuk kanë ndarë buxhet për kategoritë ekonomike, paga e mëditje, mallra e shërbime, shërbime komunale, subvencione e transfere dhe investime kapitale si dhe stafin, në këtë vitë i kemi 991 punëtorë, ndërsa në vitin e ardhshëm numri i punëtorëve është rritur për 49 norma në arsim. Pagat dhe shtesat janë në shumën e mjeteve financiare prej: 8,620,214.00€, me rritje prej: 8.70% në krahasim me këtë vitë, për mallra e shërbime janë: 2,125,968.00€, në krahasim me këtë vite, me rritje 1.59%, shërbimet e komunalive janë njësoi 350,000.00€, subvencionet e transferet janë: 1,298,675.00€ dhe investimet kapitale janë: 4,352,982.00€. Totali i buxhetit është në shumën e përgjithshme të mjeteve financiare prej: 16,747,838.00€. Në material e keni tabelën 4.1, ku e kemi ndarjen e buxhetit për programe dhe nën programe. Totali i investimeve kapitale është 4,352,982.00€, financohet prej dy burimeve, granteve qeveritare dhe të hyrave vetjake, në grandet qeveritare e kemi grantin e përgjithshëm, grantin e arsimit dhe grantin e shëndetësisë. Granti i arsimit dhe shëndetësisë është i pamjaftueshëm, për t'i mbuluar të gjitha kërkesat dhe nevojat si të arsimit, ashtu edhe të shëndetësisë. Në tabelën 4.2, i kemi projektet me 10,000.00€, të cilat i kemi vendosur në disa kode, i kemi hapur vetëm si nën programe, sepse deri në fund të vitit, do të kemi tejkalime të hyrave vetjake, për arsye të këtyre tabelave që kërkohen nga Ministria e Financave, për kufijtë buxhetorë. Në këto tabela, kanë ndodhur edhe disa gabime teknike. I kemi dy tabela tek fshati 'Bardh i Madh'

dhe e kemi bërë një gabim tek 'Rregullimi i rrethojave në varrezat e fshatit 'Miradi të Epërme' nuk është rruga 'Reçica', nuk ka investim të rrugëve, vetëm rrethoja në fshatin Miradi e Epërme.

**Laureat Gojnovci:** Buxheti i Planifikuar i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025 dhe vlerësimet e hershme 2026 dhe 2027, e kanë rëndësinë e vetë, sepse përcakton kahjen dhe zhvillimin e komunës. Kjo shpërndarje është bërë në bazë të parametrave. Ne ofrojmë shërbime Arsimore dhe Shëndetësore për të gjithë banorët e Komunës së Fushë-Kosovës, pa asnjë dallim dhe asnjë pengesë për kundër faktit që kemi mungesë të stafit arsimorë dhe shëndetësorë. Bazuar në rritjen e numrit të popullsisë dhe numrin e banorëve në Komunën e Fushë-Kosovës, buxheti për vitin 2025 është planifikuar të jetë në shumën e përgjithshme të mjeteve financiare prej: 16,747,838.00€, apo 462 mijë euro më shumë se në vitin 2024. Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve në hartimin e këtij buxheti janë marrë parasysh. Unë po filloj me kategorinë e shpenzimeve dhe kapitaleve për të gjitha drejtoritë, duke filluar prej Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, projekti - Tabela informuse - Promovimi i turizmit lokal financohet me 10,000.00€ në vitin 2025, 30,000.00€ në vitin 2026 dhe 40,000.00€ në vitin 2027, projekti - Sistemi Solar në Institucionet e Administratës, QKMF-së dhe Arsimit financohet me 70,000.00€ në vitin 2025, 174,000.00€ në vitin 2026 dhe 200,000.00€ në vitin 2027, projekti - Ndërtimi i shkollëve në Pomozotin - Parku Rekreativ në pisha të Sllatinës së Vogël në vitin 2026 financohet me 50,000.00€ dhe në vitin 2027 52,000.00€. Tek Infrastruktura Publike, projekti - Impianti i ujërave të zeza - Kolektori në vlerë prej: 100,000.00€ në vitin 2025, po ashtu edhe 100,000.00€ për vitin 2026 dhe 100,000.00€ për vitin 2027, projekti - Blerja e automjetit - Kamion me korpë, Cisternë për pastrim të rrugëve, Kamion T6, Skiper, Kamion 7 tonë, janë paraparë 80,000.00€, projekti - Ndërtimi i rrugëve bujqësore me zhavor nëpër fshatra janë paraparë 40,000.00€ për vitin 2025, 80,000.00€ për vitin 2026 dhe 66,406.00€ për vitin 2027, projekti - Ndërtimi i kanalizimeve atmosferike në qytet 10,000.00€ për vitin 2025, 180,000.00€ për vitin 2026 dhe 200,000.00€ për vitin 2027, projekti - Ndërtimi i rrethojës në varrezat e reja në Miradi të Epërme, Rr. 'Reçica' janë planifikuar 10,000.00€ në vitin 2025, projekti - Rregullimi i nënkalimit - urës në Vragoli Rr. e Pejës - M9, janë 50,000.00€ në vitin 2025, projekti - Riparimi i rrugëve të asfaltuara nëpër vendbanime - Qytet dhe Fshatra, janë 150,000.00€ për vitin 2025, 219,005.00€ në vitin 2026 dhe 250,111.00€ në vitin 2027, projekti - Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tërsishme - Kornizë, 60,000.00€ në vitin 2025, 100,000.00€ në vitin 2026 dhe po ashtu 100,000.00€ në vitin 2027. Tek Infrastruktura Rrugore janë paraparë: 1.375,000.00€ ose 31% e investimeve kapitale, ku kemi projektin - Ndërtimi i parqeve, hapësirave të reja rekreative dhe këndi i lojërave nëpër vendbanime, rruga 'Mahalla e Lartë' - Vragoli, rruga 'Udha e Malit' - Sllatinë e Madhe, rruga 'UÇK'-së - Miradi e Epërme, shuma prej: 100,000.00€ në vitin 2025, 100,000.00€ në vitin 2026, po ashtu 100,000.00€ në vitin 2027, projekti - 'Mbjellja e Pemëve Dekorative' dhe 'Vendosja e Ulëseve dhe Shportave nëpër vendbanime, qytet dhe fshatra', shuma prej: 35,000.00€, projekti - Ndërtimi i Trotuareve në rrugën Dardania - Fushë-Kosovë trotuari, ndriçimi, largimi i terasave, sinjalizim, infrastrukturë elektrike, rikonstruimi i rrugëve me: trotuare, ndriçim, infrastrukturë elektrike dhe e telefonisë, shtegu i biçikletave në rrugët: 'Hajrulla Zyri', 'Hamdi Grajçevci' dhe 'Enver Maloku'. Projekti i hapësirave me trotuar, ndërtimi i rrethojave për siguri në komunikacion në fshatrat: Vragoli dhe Sllatinë e Madhe - Rruga e Pejës - M9 shuma prej: 40,000.00€, po ashtu projekti i asfaltimit në rrugët e qytetit dhe të fshatrave. Administrata dhe Shëndetësia vlen të përmendet projekti i pajisjeve shëndetësore për QKMF-në, në shumën e mjeteve financiare prej:

140,000.00€, projekti - Blerja e Kondicionerëve për shëndetësinë – QKMF-në, QMF-të dhe AMF-të shuma prej: 40,000.00€ për vitin 2025, projekti - Blerja e gjeneratorit për QKMF-në shuma prej: 15,000.00€, projekti - Ndërtimi i QMF-së faza e dytë, rregullimi i oborrit të QMF-së shuma prej: 20,000.00€, projekti - Ndërtimi i shtëpisë për përkujdesjen e të moshuarve në Fushë-Kosovë shuma prej: 190,800.00€ në vitin 2026 dhe 300,000.00€ në vitin 2027. Kemi edhe Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me projektet si: Renovimi dhe zgjerimi i Stadiumit të Qytetit 'Ekrem Grajçevci' Fushë-Kosovë - faza e II-të, shuma prej: 230,000.00€, projekti - Palestra Sportive faza e II-të, shuma prej: 420,000.00€ në vitin 2025, po ashtu edhe projektet e stadiumeve: Rregullimi i Stadiumit në fshatin Bardh i Madh, shuma prej: 10,000.00€ në vitin 2025 dhe 50,000.00€ në vitin 2026, rregullimi i Stadiumit në fshatin Sllatinë e Madhe, shuma prej: 10,000.00€ në vitin 2025 dhe rregullimi i Stadiumit në fshatin Lismir, shuma prej: 10,000.00€ në vitin 2025, si dhe renovimi i Stadiumit në fshatin Miradi e Epërme, shuma prej: 10,000.00€ në vitin 2025, 50,000.00€ në vitin 2026 dhe 30,000.00€ në vitin 2027. Kemi edhe projektin e Renovimit të fushave të futbollit me bari sintetik tek shkollat: 'Bajram Curri' - Henc, 'Vëllezërit Frashëri' - Vragoli, 'Zenel Salihu' Pomozotin, 'Lismiri' në Lismir, shuma prej: 550,000.00€ në vitin 2026 dhe 400,000.00€ në vitin 2027. Renovimi i objektit të shkollës për arkiv - Pomozotin shuma prej: 40,000.00€ në vitin 2025, projekti Ndërtimi i Pllakave memoriale shuma prej: 20,000.00€ në vitin 2025 dhe projekti - Ndërtimi i Qendrës Multifunktionale, me projektet përcjellëse 200,00.00€ në vitin 2026 dhe 175,500.00€ në vitin 2027. Drejtoria e Administratës së Arsimit, projekti - Blerja e Invertarit për shkollat 'Mihal Grameno', 'Selman Riza', 'Vëllezërit Frashëri', projekti - Ndërtimi i shkollës në Fushë-Kosovë faza e dytë, shuma prej: 340,000.00€ në vitin 2025, projekti - Rregullimi i oborrit të shkollës filllore 'Zenel Salihu' në Bardh të Madh shuma prej: 30,000.00€ në vitin 2025 dhe projekti - Ndërtimi i Çerdheve në Sllatinë të Madhe dhe Miradi të Epërme, shuma prej: 100,000.00€ në vitin 2025, 200,000.00€ në vitin 2026 dhe 300,000.00€ në vitin 2027, andaj në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozoi që 'Buxheti i Planifikuar i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025 dhe vlerësimet e hershme për vitin 2025' të aprovohet.

**Durim Hajra:** Faleminderit i nderuar Kryesues. Sa i përket këtij buxheti, është buxheti i fundit për mandatin dhe qeverisjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës në Fushë-Kosovë, unë mendoj se nuk ja vlen me dhënë më vërejtje sa i përket përpilimit të këtij buxhetit, mirëpo fokusi kryesor i këtij buxheti është ajo se çka është premtuar, e që ka qenë një projekt katër vjeçar të Kryetarit në ikje z. Burim Berisha dhe çka është realizuar sa i përket këtyre premtimeve. Shumica prej tyre kanë qenë mashtrime elektorale, kush do që ka pas mundim me shfletuar dhe me shikuar se çka është bërë me buxhetet e kaluara. Brenda këtij mandati është premtuar që kanë me u investuar 3.2 milion euro në zgjerimin dhe renovimin e Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë, shëtitortja në lagjen 'Dardania' në vlerën prej: 2 milion euro, shtëpia për kujdesin e të moshuarve në vlerë prej: 300 mijë euro, qendra stomatologjike, dy salla të sportit në vlerë prej: 400 mijë euro, katër çerdhe publike, qendra multifunktionale investim prej: 4.1 milion, rruga Fushë Kosovë - Prishtinë përgjatë hekurudhës me trotuar, shteg për biçikleta në vlerë prej: 400 mijë euro, projekti i parkut të madhe prej 80 hektarësh në Nakaradë, pse nuk është planifikuar as në këtë vitë buxheti, për ndërtimin e tregut në Bresje. Projekti për ndërrimin e tjegullave të shtëpive në fshatrat Harilaç e Graboc i Poshtëm dhe disa fshatra, renovimi dhe zgjerimi i stadiumit në fshatin 'Miradi e Poshtme' dhe fshatin 'Lismir' asnjë cent, 150 mijë euro për sallën e sportit në 'Graboc i Poshtëm', hartimi i planit turistik për fshatin 'Pomozotin', projekti i parkut Ligatinat e Hencit, salla e sportit

në Nakaradë, mësimi gjithë ditore e shumë e shumë premtime tjera, që nuk kanë pas implikime buxhetore që nuk janë përfshirë, zgjerimi i objektit të shkollës në fshatin 'Miradi e Epërme' dhe investimi në shtretërit e lumenjve. Vlera mesatare e këtyre projekteve del afërsisht 13,500.000.00€, prej 18 milion për investime kapitale, investime reale kapitale dalin afërsisht 4.3 milion euro, që i bien se 76% të asaj që ky kryetar, që është aktualisht e ka pas mashtrim, këtë e vërteton edhe sot nëse kalon ky buxhet. Unë po i përmendi vetëm disa vërejtje dhe nuk e di, a vlen mu thelluar më shumë në këtë planifikim buxhetor, sepse shumë pak në projekte dallon prej buxheteve tjera dhe është shumë larg realitetit të asaj çka është premtuar, çka u planifikua dhe çka po planifikohet. Projekti numër tre - tabela informuese, promovimi i turizmit lokal, ta qesim njëherë monitorin, që e kemi planifikuar dhe ka kaluar në buxhet, pastaj i vjen rendi kësaj, sepse ka gjëra edhe ma të rëndësishme që mundën me u bërë. Projekti 8 dhe 9 - ndërtimi i rrugëve bujqësore me zhavorr në fshatra janë planifikuar 20 mijë euro ndërsa tek, ndërtimi i kanalizimit atmosferik në qytet, ku çdo herë kur ka reshje, ka dëme tek qytetarët, janë planifikuar 10,000.00€, kjo është e çuditshme. Projekti 20, rregullimi i rrugës 'Dardania' në Fushë-Kosovë, trotuar, ndriçim, largim i terasave, sinjalizimi infrastruktura elektrike në faza prej: 295 mijë euro, ju i keni mashtruar qytetarët për shëtitoren 'Dardania', projekti 23 - ndërtimi i rrethojave për siguri në komunikacion në fshatin Vragoli dhe Sllatinë e Madhe, për këtë mandat është zero buxhet, kemi katër raste mediatike, që qytetarët e kanë humbë jetën për arsye të kësaj rruge, e ju keni planifikuar zero buxhet për vitin 2025 dhe këtu tregohet serioziteti i kësaj qeverisje në Fushë-Kosovë, ndërtimi i shtëpisë për kujdesje të moshuarve, ka qenë premtim elektorale dhe prapë e keni paraparë për vitin 2026, renovimi dhe zgjerimi i Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë, janë premtuar 3.2 milion dhe janë buxhetuar për vitin e fundit, vetëm dyqind e pesë dhjetë mijë euro dhe komplet renovimet janë bërë prej Federatës së Futbollit të Kosovës, jo prej investimit të Komunës së Fushë-Kosovës. Ndërtimi i Qendrës Multifunktionale është 4.1 milion, janë premtuar dhe të paktën si keni planifikuar një qind mijë euro. Dua të ndërlidhem me Shefin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ku tha se buxheti përcakton kahjen dhe zhvillimin e komunës, kjo është e saktë se me këtë buxhet, ne ia kemi dhënë kahjen, ku 76% të premtimeve si keni realizuar deri tani dhe po dihet kah ka marr kahje kjo qeverisje, pjesa ku ish Shefi i buxhetit na thotë, ju nuk i dini, kini kohë me i mësuar dhe unë them kështu kurrë mos u mësofsha. Sa i përket kësaj tabelës tek të hyrat vetjake, asnjëherë nuk ju kemi kritikuar që qëndroni keq tek të hyrat vetjake, por interesi i qytetarëve është me ju përkthyer me investime kapitale, i keni pas bartje, nga pesë milion të buxhetit për investime kapitale, qytetarët i paguajnë taksat dhe kanë zgjedhur me ardhur me jetuar dhe me zhvilluar biznes këtu, realisht i obligon ligji me paguar taksa.

**Mirsad Qyqalla:** Po filloj me Zhvillimin Ekonomik, projekti numër tre - tabela informuese, Promovimi i Turizmit Lokal, jam shumë kureshtarë kur të hapet drejtor kjo tabelë për informim, me parë se çka po promovoni, sepse në pjesën e turizmit, përveç një parkut të pishave, nuk kam parë diçka më shumë për turizëm, vazhdojmë tek projekti numër shtatë, edhe herën e kaluar i keni listuar disa gjëra që duhet mi blerë, pyetja ime është, se a kanë mu blerë të gjitha këto që janë të cekura në këtë projekt, nëse është një prej tyre, pyes, pse është e vështirë mu identifikuar cila, një buxhet që ta planifikon një komunë me kompletë një infrastrukturë të personave të nevojshëm, nuk është në gjendje me identifikuar se çka ka me blerë, për mua kjo është dështim dhe këtu tregon se si menaxhohet buxheti. Pjesa tjetër ndërtimi i rrugëve bujqësore me zhavorr nëpër fshatra, ky shabllon është i përsëritur çdo vitë dhe unë nuk po mundem me kuptuar, me tërë këto probleme

nëpër rrugë, me dhënë mjete financiare edhe për ara nuk po kuptojë. Kanalizim atmosferik në qytet si të ketë reshje shiu e bllokun qytetin dhe mi ndarë një shumë të mjeteve financiare prej: 10,000.00€, për mua është e pa pranueshme. Tek projekti numër dhjetë, ndriçimi i rrethojës tek varrezat e fshatit 'Miradi e Epërme, rruga 'Reçica', në Komitetin për Politikë dhe Financa, na është thënë se atje do të bëhet një rrethojë për të cilën ne nuk kemi as vendim dhe ajo pronë është pronë e një privati komplet, ndërsa sot ju dilni dhe thuani, se është një gabim teknik, unë mendoi se përgjigjia këtu është e pamjaftueshme, kjo pronë flitet për pesë vite, ka probleme dhe me planifikuar me rrethoja kjo punë lenë shumë për të dyshuar. Projekti dymbëdhjetë tani ju z. Bardhyl Koiçiçi, riparimi i rrugëve të asfaltuara, mi ndarë 150,000.00€ për riparim të rrugëve në qytet dhe fshatra dhe mos me qenë në gjendje mi specifikuar cilat rrugë, këtu po dëshmohet mënyra se si po funksionon. Projekti trembëdhjetë - Vendosija e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tërësishme, i keni ndarë 60,000.00€, po përfundon viti i tretë dhe nuk ka ndriçim publik dhe në vazhdimësi i kemi pasur këto probleme dhe vazhdojmë njëjtë, prapë në terr. Projekti numër pesëmbëdhjetë - Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në fshatrat: Harilaç dhe Graboc i Poshtëm, kur e sheh shumën e mjeteve financiare prej: 250.000.00€ lenë për të dyshuar. Ndërtimi dhe Riparimi i trotuareve nëpër qytet dhe fshatra, asnjë informatë shtesë tek ky projekt, mirëpo kur vjen dhe e prezanton një buxhet duhet me ditë saktë ku, se në bazë të kësaj ju s'keni specifikuar asgjë. Projekti numër njëzet - Rregullimi në rrugën 'Dardania' në Fushë-Kosovë, për dhjetë vite ka qenë sheshi, tani e keni kthyer rruga 'Dardania', trotuaret, ndriçimin, largimin e terasave, sinjalizimin, pyetja ime është, a keni hequr dorë nga sheshi, nëse po çka ka ndodh me një kompani e cila na i ka marrë dy qind mijë euro dhe qytetarët duan ta dinë, se a ka me pas sheshe në rrugën 'Dardania' apo jo, sepse jemi qyteti i vetëm që nuk kemi shesh. Projekti numër njëzet e dy - Bardh i Madh, Sllatinë e Madhe, Pomozotin dhe Graboc i Poshtëm prej: 200,000.00€, është total e palexueshme ndërsa për vete i keni me ngjyra. Tek pjesa e asfaltimit në fshatra, për çudi kësaj radhe fshati 'Graboc i Poshtëm' dhe 'Lismiri', e çuditshme me përfunduar me 10,000.00€ asfalt, ndërsa 40,000.00€ mi ndarë për zhavorr, unë nuk pajtohem me këtë pjesë. Tek Kultura dhe Sporti, i keni katër stadione në vlerën prej: 10,000.00€, renovimi i stadiumit të 'Lismirit' 10,000.00€ jam kureshtar ta di, se çka keni me bërë me këtë shumë dhe si ka mundësi kërkesat e ndryshme e mjetet e njëjta financiare. Renovimi i fushave të futbollit me bari sintetik, pashë që nuk ka asnjë cent të ndarë edhe pse janë në gjendje të mjerueshme dhe kanë nevojë. Ndërtimi i Qendrës Multifunksionale dështim edhe pse ka qenë premtim i fushatës elektorale. Ndërtimi i çerdhes në fshatrat: Sllatinë të Madhe dhe Miradi e Epërme, pash që ishin ndarë 100,000.00€, unë po them duke e parë çmimin e tregut, nuk e di a do t'ia dilni, kërkesa ime është mos i ndërtoni, nëse nuk mundeni me i funksionalizuar. Prej se jam këtu buxhet ma të dobët, asnjëherë nuk kam parë dhe 70% e premtimeve të juaja nuk i keni mbajtur, e lërë më realizimin e kërkesave të qytetarëve.

**Hasan Ismajli:** Këtë buxhet e ka përgatit Ekzekutivi i Komunës, i cili është lodhur shumë dhe kanë humbur kohë. Vetëm unë si asambleistë dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kemi marrë pjesë, në çdo debat publik dhe kemi pasur disa kërkesa dhe të gjitha na u kanë injoruar dhe këto kërkesa kanë qenë për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, jo për mua. Unë kam kërkuar investim tek lagjësja 'Kollonia', e cila lagje është lagjja më e vjetër në Komunën e Fushë-Kosovës dhe nuk keni ndarë asnjë centë për rregullimin e rrugës, trotuarit dhe ndriçimit, nuk është në rregull, sepse ato banesa janë të viteve të 50 - ta. Po ashtu e kam ngritë edhe çështjen e varrezave nga dita e parë e mandatit tim në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës, deri në fund të vitit më



s' do të ketë vende në varrezat e Fushë-Kosovës. Ndërsa ju ka ra ndërmend, mi ndarë parat, për me i rrethuar varrezat në fshatin 'Miradi e Epërme' dhe 80 ari të atij privatit, pastaj mi marrë 80 ari dhe mi ja dhënë 1 hektar e 90 ari më poshtë, sepse aty e keni pikën dhe pazaret i kini bashkë. Por banorët nuk janë të pajtim dhe po ju pengojnë. Ju një shtatore të 'Ibrahim Rugovës', nuk keni menduar me ja vendosur. Katër vite në mandatin e kaluar Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ka folur në këtë foltore dhe ka kërkuar, që kjo sallë të digjitalizohet dhe shkuan edhe tri vite të këtij mandati dhe nuk është digjitalizuar, shumë keq. Nuk keni ndarë asnjë cent për transportin e fëmijëve me nevoja të veçanta, s'po ju kuptoj çka po mendoni ju, vetëm lus që mos të keni asnjë rast me fëmijë me nevoja të veçanta në shtëpitë e juaja. Drejtorja e Arsimit, kur shpërndan bursa i fut edhe këtë kategori por këta paguhen me kodin e bursave për student, unë mendoi se kjo kategori duhet me pasur një buxhet të veçantë. Nuk keni paraparë asnjë ndihmë për lehonat, z. Laureat Gojnovci doli e lexoi aq mirë dhe me një krenari planifikimin e buxhetit, mirëpo me dal vetëm tre metër jashtë kësaj salle dhe me hyrë në tualetet e komunës është për keq ardhje, duhet me shikuar ku po e qetë këmbën, ujë nuk ka e dilni i lexoni gjashtëmbëdhjetë milion euro, z. Bardhyl Koçiçi, keni harruar me i shti në buxhet edhe oborret private me i shtruar, sepse pjesa më e madhe e asfaltit shkojnë nëpër oborret private. Zgjerimi i stadiumit në Fushë-Kosovë, unë hapat e parë si fëmijë i kam marrë në këtë stadium dhe kjo pronë e stadiumit, nuk është pronë e komunës, qyteti i Fushë-Kosovës me një numër të madhe të banorëve, e meriton një stadium më të mirë, se që është ky tani, por nuk po kuptoi si do ta zgjeroni, sepse ky stadium është në pronë të huaj, nuk po e di si po i ndani 10,000.00€. Kryetari i Komunës e ka pasur premtim edhe për stadiumin në Lismir, prapë nuk e di ku do investoni aty, sepse ajo është pronë është e KEK-ut, mos qitni para aty ku nuk i keni pronat e juaja, sepse pronat të cilat janë të komunës, unë po i kërkojë për katër vite Drejtorit të Kadastrit, por nuk i jep sepse s'ka çka të jep dhe i vjen mërzi kur unë i kërkojë. Unë kam kërkuar në çdo debat publik me u përfshirë lagjja 'Kollonia', mirëpo nuk e keni marrë parasysh kërkesën time dhe për një grusht vota tek lagjja 028 dhe 029, edhe pse nuk kamë asgjë kundër sepse me të vërtet kanë nevojë, keni shkuar i keni lutur prej tri kërkesave, ta zgjedhin një cilën po dëshironi, sepse tani tri kërkesa nuk kemi mundësi, ndërsa lagjen 'Kollonia' e keni lënë në mëshirë dhe arsyet pse unë nuk e votoj këtë buxhet janë këto.

**Artan Asllani:** Komuniteti çdo herë e potencoj se duhet me pas gjithë përfshirje dhe vazhdimisht kontaktet të cilat i kemi pasur me Nënkryetarin e Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive, deri sa është hartuar ky buxhet, më kanë premtuar, se ka me pasur gjithë përfshirje për komunitetet dhe po dua me cek një çështje e cila nuk ka ndodh asnjëherë në historinë e udhëheqjes së Fushë-Kosovës, çështja e marrëveshjes me USAID-in, mendoi se është shumë pozitive, sepse për herë të parë, ju ka dhënë mundësia që qytetarët vetë me zgjedhin, se çka po duan në lagjen e tyre. Tek ne janë përfshirë dy çështje, njëra tek Shërbimet Publike, ku u ngritë edhe kodi i ri 451, që është për asfaltimin e lagjes 028 dhe 029, si dhe lagjes 02 rruga 'Konstandin Kristoforidhi', që janë ndarë edhe 60,000.00€ plus për këtë lagje, ndryshe prej vitit të kaluar në këtë buxhet. Zyra për Komunitete dhe Kthim ka 3,000.00€ për subvencione, ndoshta janë pak për komunitete, sepse e dimë se numri i komuniteteve është i madh. Me Drejtorët e linjës dhe Nënkryetarin e Komunës, kemi biseduar që disa rrugë në lagjen 028, ende kanë mungesë të kanalizimit dhe asfaltimit dhe do mundohemi me i përfshirë në kodin e ri që është hapë. Komunitetet kanë gjithë për fshirje edhe në arsim dhe shëndetësi.

**Hasan Ismajli:** I nderuar z. Artan Asllani, kur del në foltore kisha pasur dëshirë që të më citon ashtu qysh e them, sepse unë jam i vetmi asambleistë që më së shumti kam vërejtje në procesverbal, unë mbajë mend shumë. Unë thashë të vetmin debat me qytetarë, këta zotëri e kanë bërë në lagjen e juaj, të gjitha debatet tjera kanë qenë këtu. Keni pas tri projekte, s'kanë pas mundësi tri dhe keni bërë pazar dhe ka shkuar një projekt, mirëpo edhe tri projekte me pas shkuar absolut nuk jam kundër. Unë ndjejë keqardhje për çdo komunitet që jeton në kushte të vështira dhe e paraqes edhe këtu, sepse unë jam rritur me komunitete. Unë këtyre ju thashë tek një pjesë e qytetarëve keni shkuar dhe pse nuk keni shkuar edhe nëpër fshatra, sepse edhe në fshatra keni mundur të debatonit me qytetarë, po ashtu edhe në lagjen 'Kollonia' keni mundur të shkoni dhe të debatonit me qytetarët, aty ka edhe komunitete dhe trotuar nuk kanë për me ec, fëmijët e tyre vinë në shkollën 'Selman Riza' dhe as ndriçim nuk kanë, ndërsa nëpër fshatra, e bëjnë ndriçimin për vete dhe e qesin në facebook.

**Shpend Bardiqi:** Kur e lexoj buxhetin që vjen nga Ekzekutivi i Komunës them, a jemi të njëjtës komunë, a rrimë me të njëjtit qytetarë, unë mendoj se buxhetin ose e përgatitë dikush që nuk rrinë asnjëherë në komunë, sepse ky buxhet të cilin e keni planifikuar për vitin 2025, 2026 dhe 2027 nuk përkon me kërkesat e qytetarëve, që neve na drejtohen z. Artan unë e kujtoj kur unë e kam propozuar një Drejtori për Komunitete dhe Kthim, prej Komitetit për Komunitete ka ardhur këtu dhe më duket, se as ju nuk e keni votuar, sepse me sa e di unë nuk ka hyrë, as si pikë e rendit të ditës. Unë e kam një kërkesë për me ua votuar buxhetin, shembull nëse i'a kishim ndalë pagën Drejtorit të Financave dhe Buxhetit edhe disa zyrtarëve aty, ne e kishim votuar buxhetin, sepse tek shpenzimet e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet ishin afërsisht 25,600.00€, paga neto, pse ne mi hargjuar këtë shumë të mjeteve financiare për paga kur në fund Drejtoria e Infrastrukturës, na e përgatitë buxhetin, del këtu Drejtori i Infrastrukturës me elaboruar buxhetin dhe i duket krejt normale kjo, deri kur duhet me paguar shteti jonë, njerëz që nuk punojnë, e nuk vinë as në punë. Shtesa për vëllimin e punës, ju nuk jeni duke i kryer punët e juaja, e me marr shtesa për vëllimin e punës me të vërtetë e pa kuptim. Kam një pyetje për ju z. Bardhyl Kojçiçi, kompensimi i përfaqësimit brenda vendit, a është për ju ky kompensim, sepse ju jeni duke e përfaqësuar Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit?

**Aida Alimi:** Për mua ky planifikim është i pa pranueshëm, duke parë gjendjen në qytet. Ta kenë të qartë të gjithë qytetarët se edhe këtë vitë, do të ballafaqohen me probleme të njëjta, po ashtu tek shëndetësia dua ta di, a është e planifikuar me blerë Mamografin, të cilën unë e kërkoj prej se kam filluar për herë të parë në këtë Kuvend. Kisha kërkuar prapë për fillimin e procedurave, që duhet me i ndjekur për Mamografi, sepse është shumë e nevojshme. Unë me këtë planifikim pajtohem vetëm tek çështja gjinore, që është një rritje, tjerat janë të pa pranueshme.

**Migjen Kolshi:** Unë dua të filloj me dëgjimin buxhetor, drejtor unë kam qenë prezent dhe kam kërkuar nga ju me mbajtur një dëgjim me banorët e fshatit Harilaç dhe më keni premtuar se do ta mbajmë dhe nuk e keni mbajtur premtimin, edhe pse keni bërë shumë mirë që keni mbajtur në lagjen 028 dhe 029. Unë dua të ndalem tek investimet në fshatin Harilaç, unë kam dhënë një premtim se nëse ndahet një shumë për ujësjellësin, unë do e votojë buxhetin, por nuk e keni ndarë. Keni ndarë një shumë të mjeteve financiare prej: 250,000.00€ për dy fshtrat: Harilaç dhe Graboc i Poshtëm për ujësjellës dhe kanalizim dhe kjo mua, po më lë për të dyshuar, sepse nuk janë të ndara sa për njërin fshat dhe sa për tjetrin fshat. Në këtë buxhet janë ndarë vetëm 10,000.00€ për asfaltim. Në fshatin Harilaç nuk ka fushë të futbollit, para disa viteve kanë filluar punimet për një

fushë, mirëpo është ndërprerë dhe është i vetmi fshat që nuk ka fushë të futbollit, po ashtu në fshatin Harilaç nuk ka mësues për parashkollorë, unë nuk e di se çka po ju pengon që mos të investoni në fshatin Harilaç, shumë më shumë ka investime në fshatrat tjera, sesa në fshatin Harilaç dhe për mua të gjitha janë të dyshimta, se a do të bëhen apo jo. Të kishte qenë krejt kjo shumë e mjeteve financiare vetëm për fshatin tim, kisha besuar, mirëpo në këtë situatë jo. Investimi tek 'Kalaja e Harilaçit' premtimi i Kryetarit të Komunës për mirëmbajtje dhe nuk ka investim, ndërrimi i pullazeve, as ajo s'ka ndodh edhe pse kanë premtuar. Ky buxhet për fshatin e Harilaçit është i pa pranueshëm.

**Vloujat Hasani:** Faleminderit kryesues. Ne i kemi pasur disa diskutime edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, kolegët të cilët ishin paraprakisht në foltore i thanë po thuaj se të gjitha ato që unë pata me i thanë. Buxhetet e kaluara të cilat i ka përgatitur Komuna e Fushë-Kosovës çdo herë kanë qenë jo në rregull, nuk kanë qenë të planifikuara mirë dhe asnjë herë nuk kanë dalë reale me dokumentacion të cilin na kanë ofruar, e që edhe në këtë buxhet po përsëritet e njëjta, ky planifikim nuk është në rregull. Në Komitetin për Politikë dhe Financa, unë ngrita çështjen në lidhje me ndërtimin e rrethojave në fshatin 'Miradi e Epërme' në rrugën 'Reçica', ky planifikim sjellë në vete shumë probleme, shumë bashkë fshatar të mijë dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, janë marrë me të njëjtin problem dhe mos zgjedhja e këtij problemi vite me radhë është transferuar tani edhe tek unë. Si me duket mua ky planifikimi i prezantuar sot nga ana e Ekzekutivit të Komunës, po krijon një lloj përçarje në mes banorëve të këtij fshati, sepse kërkesat e këtyre banorëve të cilat janë shprehur edhe në diskutimin publik, nga ana e Ekzekutivit të Komunës i'u është premtuar banorëve se do ta mbajnë edhe një diskutim publik brenda fshatit Miradi e Epërme, i cili nuk është mbajtur dhe ende nuk është marrë asnjë vendim në lidhje me varrezat në fshatin Miradi e Epërme, kurse tani na ofrohet një planifikim i buxhetit, i cili parasheh ndërtimin e rrethojave për varrezat në rrugën 'Reçica' të fshatit Miradi e Epërme, unë nuk po kuptoi se kah i ka ardhur Ekzekutivit të Komunës, ky planifikim pa u konsultuar paraprakisht me banorët e këtij fshati, kërkesat për planifikim vinë nga qytetaret në diskutimi publik, sipas gjithë kësaj ky planifikim është bërë vetëm për të shkaktuar përçarje ndërmjet banorëve të këtij fshati. Në Komitetin për Politikë dhe Financa, na është thënë, se ka pasur kërkesë të banorëve për këtë çështje, ndërsa sot paska rrjedhur një gabim në rrugën 'Reçica' dhe nuk na është treguar, se çka po ndodh me këtë gabim dhe ne sot kemi me votuar për këtë planifikim që na është dorëzuar, ne nuk po e dimë, se çka kemi me votuar, a me votuar rrethojën apo gabimin teknik, të cilin ju e quani ashtu. Te projekti 15 është ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit në fshatrat Harilaç dhe Graboc i Poshtëm, për tri vite me radhë e ngrisim si çështje problemin e rrugës 'Lumi' në fshatin Miradi e Epërme dhe në këtë planifikim nuk po e shohë këtë projekt, ka me përfunduar një mandat i tërë dhe kjo rrugë është e diskriminuar për realizimin e investimit publikë, të nevojshëm për banorët e kësaj rruge të fshatit tonë. Ndërtimi dhe riparimi i trotuareve nëpër vendbanime në qytet dhe në fshatra, e keni ndarë një pjesë prej: 100,000.00€ për të cilat specifika nuk besoi që keni dhe as që i keni menduar, ne jemi mësuar me juve, që ju vetëm i vendosni shifrat që t'i kamufiloni para qytetarëve, këtu po i shohim disa rrugë që kanë me u asfaltuar, ku janë ndarë 100,000.00€ dhe prapë problemi i rrugës 'Idriz Breznica' në Fushë-Kosovë, nuk është vendosur askund në këtë planifikim dhe rrugë është me të vërtetë keq dhe ka nevojë për intervenim, ju nuk e keni planifikuar dhe qytetarët duhet të njoftohen se nuk jeni duke punuar për ta. Dy çështje të fundit, asfaltimi i rrugës në fshatin Miradi e Epërme janë ndarë 10,000.00€ edhe është ndarë rruga 'Bregu i Madhë',

'Lumi' dhe 'Gërvalla'. Asfaltimi i rrugës 'Bregu i Madh' ka përfunduar para dy muajve, çka po doni me bërë me këtë rrugë? A keni bërë ndonjë planifikim, jo të duhur para dy muajve që tani doni me mbyllë me këtë buxhet, apo mendoni edhe njëherë me asfaltuar, nuk po e di, por unë po e shoh që këtu diçka nuk është në rregull, njëherë u asfaltua, e tani po e planifikoni me asfaltuar e çuditshme dhe unë mendoj se shuma e mjeteve financiare prej: 10,000.00€ janë shumë pak për rrugët, të cilat kanë nevojë për intervenim, jo vetëm në fshatin Miradi e Epërme por në të gjitha fshatrat tjera. Por pasi që jemi tek fshati Miradi e Epërme, renovimi i fushave të futbollit me bari sintetik në shkollat të cilat janë cekur këtu, Drejtori i Arsimit ka qenë pjesëmarrës në disa ndeshje të futbollit të vogël, në turnirin e organizuar në fshatin Miradi e Epërme, ku garuesit kanë shkuar në finale kanë marrë mirënjohje, edhe Drejtori z. Ekrem Berjani është shpërblyer me mirënjohje, me këtë rast Komuna e Fushë-Kosovës, e cila ju ka ndihmuar klubeve sportive, ka premtuar që të bëjë renovimin e kësaj fushe të futbollit tek shkolla, sepse turnirët po mbahen nëpër fusha private për arsye të mungesës se fushave tona, andaj unë në këtë planifikim nuk po e shoh këtë premtim që është dhënë. Tani a ka me u ndërruar ky destinim i investimeve, tani kemi me pa këtë, se premtimi i'u është dhënë banorëve, që kjo fushë do të rregullohet, normalisht kjo fushë është dashur të rregullohet, pa u dhënë premtimi banorëve, sepse është obligim. Për hirë të korrektësisë tek projekti i fundit me Nr. 65, të cilin e kemi në planifikim ndërtimi i çerdheve në fshatrat: Sllatinë të Madhe dhe Miradi e Epërme, drejtor të falënderoj që e keni inkorporuar në planifikim, po shpresoj që kjo të realizohet, sepse kemi biseduar që është e nevojshëm ndërtimi i çerdhes në këto fshatra dhe e vetmja çështje, që unë pajtohem me këtë planifikim buxhetor është kjo.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunës:** Propozimi im sa i përket buxhetit për vitin 2025, kërkojë tek kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve shuma e mjeteve financiare prej: 80,000.00€, që i dedikohen çështjes së shërbimeve të varrimit, kërkojë që kjo shumë të rritet edhe për 10,000.00€, për qëllim të zbatimit të 'Rregullores për shërbime të varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'. Tani unë dua t'i hedhë në votim dy propozimet si vijon: Propozimin e Shefit të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta marrë shumën e mjeteve financiare prej: 10,000.00€ tek renovimi i shkollave dhe kalimin e saj për digjitalizim dhe Propozimin tim sa i përket buxhetit për vitin 2025, kërkoj që nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve shuma prej: 80,000.00€ që i dedikohen çështjes së varrezave, të rritet edhe për shumën prej: 10,000.00€, me qëllim të zbatimit të 'Rregullores për shërbime të varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim në votim për aprovim 'Propozimin që shuma e mjeteve financiare prej: 80,000.00€ të rritet dhe të bëhet 90,000.00€, te kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve te Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit', me qëllim të 'Rregullores për shërbime të varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2025'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', 'asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim e aprovon 'Propozimin që shuma e mjeteve financiare prej: 80,000.00€ të rritet dhe të bëhet 90,000.00€, te kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve te Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit', me qëllim të

'Rregullores për shërbime të varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2025'.

Tani e qes në votim 'Propozimin e Shefit të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta marrë shumën e mjeteve financiare prej: 10,000.00€ tek renovimi i shkollave dhe kalimin e saj për digjitalizim'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim e aprovon 'Propozimin e Shefit të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta marrë shumën e mjeteve financiare prej: 10,000.00€ tek renovimi i shkollave dhe kalimin e saj për digjitalizim'.

Tani e qes në votim për aprovim 'Propozimin për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, në shumë të përgjithshme prej 16,747,838.00€, i shpërndarë nëpër programe e nën-programe të kategorive ekonomike dhe vlerësimet e hershme për vitin 2026 dhe 2027, me dy ndryshimet e aprovuara më lartë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', nëntë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovon 'Propozimin për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, në shumë të përgjithshme prej 16,747,838.00€, i shpërndarë nëpër programe e nën-programe të kategorive ekonomike, me dy ndryshimet e aprovuara dhe vlerësimet e hershme për vitin 2026 dhe 2027' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, në shumë të përgjithshme prej 16,747,838.00€, i shpërndarë nëpër programe e nën-programe të kategorive ekonomike si vijon:
  - 1.1 Për paga dhe mëditje për 1040 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 8,620,214.00€;
  - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 2,125,968.00€;
  - 1.3 Për shpenzime komunal, buxheti i komunës është në shumë prej: 350,000.00€;
  - 1.4 Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,298,675.00€ dhe
  - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,352,982.00€.
2. Vlerësimet e hershme të caktuara me kufijtë për Buxhetin e Planifikuar me Komizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2026, është në shumë të përgjithshme prej: 17,592,179.00€ dhe për vitin fiskal 2027, është në shumë të përgjithshme prej: 18,456,253.00€.

**Pika e katërt (4) - Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Këshillin Bashkiak të Bashkisë së Tiranës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Sqaroi se tani për arsye të aspekteve administrative dhe procedurale që mund të zgjaten nga ana e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, meqë jemi në fund të muajit kalendarik, mbyllet periudha buxhetore, kërkova që këtë pikë ta shqyrtojmë pas shqyrtimit të buxhetit, andaj tani e kemi në shqyrtimi 'Rekomandimin e dalur nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, për shqyrtimin e kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të

anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Këshillin Bashkiak të Bashkisë së Tiranës', tani e kemi të definuar edhe agjendën e vizitës tonë. Hap diskutimin.

**Mirsad Qyqalla:** Ne këtë çështje e kemi diskutuar edhe me kolegët nga të gjitha subjektet politike, por meqë mjetet financiare duhet të mirren edhe nëpër disa kode tjera, jashtë Zyrës së Kuvendit të Komunës në mungesë të buxhetit, kërkojmë që këtë propozim ta aprovojmë tani, ndërsa sigurimi i mjeteve financiare të bëhet nga ana e Ekzekutivit të Komunës.

Pas sqarimeve të dhëna Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e çiti në votim 'Rekomandimin e dhënë nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, për aprovimin e Kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Këshillin Bashkiak të Bashkisë së Tiranës'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Rekomandimin e dalur nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, lidhur me realizimin e Kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Këshillin Bashkiak të Bashkisë së Tiranës' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për lejimin e vizitës zyrtare në Republikën e Shqipërisë në muajin tetor 2024, e lidhur me ftesën e Bashkisë së Tiranës - Këshillit Bashkiak të Tiranës.
2. Organizimi i vizitës zyrtare bëhet nga data: 03-06.10.2024, sipas ftesës zyrtare të Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 36217, të datës 23.08.2024.

**Koha e pushimit në kohëzgjatje prej një orë.**

**Pika e pestë (5) - Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024'. Hap diskutimin.

**Mirlinda Krasniqi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, e paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara në secilin sektor, duke filluar nga Drejtoria e Administratës, ku shihet një efikasitet në dhënien e shërbimeve të certifikatave të ndryshme për qytetarët e komunës, pastaj nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik është bërë regjistrimi i 1254 obliguesve të ri tatimorë si njësi, janë regjistruar 355 biznese të reja, janë dhënë vërtetimet për personat dhe familjet nën asistencë sociale, në kuadër të Sektorit të Tatimit në Pronë, janë evidentuar me sukses pronat e reja, në Drejtorinë e Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, efikasitetit në realizimin e lëndëve, që janë shqyrtuar dhe vendosur është 96%, nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë realizuar gjithsej 117 mijë vizita shëndetësore dhe janë dhënë 278 mijë shërbime të natyrave të ndryshme shëndetësore nga ana e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë dhe Qendrat tjera të Mjekësisë Familjare, në arsim është paraqitur një raport më ndryshme prej raporteve të kaluara, me shumë aktivitete nga Drejtoria e Arsimit dhe në shkollat tona, që evidentohen edhe me anë të fotografive nga aktivitetet e realizuara në këtë gjashtëmujorë nëpër institucionet arsimore, prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit është intervenuar në rregullimin e



njeteve të kanalizimeve dhe njetit të ndriçimit publik, ne vlerësojmë se këto punë janë realizuar me kapacitete minimale në aspektin human, të cilët këto punë i kanë kryer duke e dhënë një kontribut të madh në kryerjen e punëve, njësoi është vepruar nga shumica e Drejtorive të Komunës, që ofrojnë shërbime për qytetarët e komunës tonë, andaj ne punën dhe aktivitetet e realizuara në gjashtëmujorin e parë i vlerësojmë pozitivisht dhe kërkojmë që në të njëjtën mënyrë të vazhdohet edhe në periudhën e ardhshme.

**Mirsad Qyqalla:** Tani këtu në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, nuk është askush prezentë për të dhënë sqarime për raportin e punës për periudhën gjashtëmujore, mungon Nënkryetari i Komunës, këtu raporti vjen si përshkrim i detyrave të punës nëpër sektorë, madje tek Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, është njëjtë sikur vitin e kaluar, ku thuhet se në kohën e dimrit, të gjitha rrugët kanë qenë të lira dhe të kalueshme, ndërsa rrugët kanë qenë të bllokuara me borë, ndërsa eksponentë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, janë lavdëruar kur janë pastruar rrugët. Pastrimi i varrezave ka përfunduar në fshatin Lismir, ndërsa nuk është bërë në të gjitha fshatrat dhe qytet njëjtë, ndërsa nga Drejtoria e Inspektoratit nuk është punuar në lirim të hapësirave publike, nga kjo drejtori nuk është kryer puna për të cilën ata funksionojnë, këtu puna e tyre duhet të shihet në teren.

#### **Pika e gjashtë 6) - Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar të komunës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi në shqyrtim 'Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar të komunës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024', ftoi znj. Merita Krasniqi - Udhëheqësen e Sektorit për Financa dhe Buxhet, që të na jap sqarime.

**Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar - qershor 2024, ne këtu juve ju informojmë për shpenzimet periodike, ecurinë e grumbullimit, obligimet e komunës, që e paraqesin dinamikën e mjeteve financiare të shpenzuara dhe të hyrat vetjake, duke u mbështetur në standardet të kontabilitetit integral, ku ne mund t'i lexojmë pasqyrat qeveritare dhe llogaritë e komunës së Fushë-Kosovës, të gjitha pranimet dhe paratë e gatshme, ky hyn buxheti i komunës prej 16 milion dhe bartja e buxhetit të pa shpenzuar në shumën e mjeteve financiare prej 6.3 milion euro, pastaj participimet dhe në fund arrihet shuma prej 22 milion euro, deri tani alokimet kanë qenë në shumën e mjeteve financiare prej 18 milion eurove, prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 5,570,327.77€ për mallra dhe shërbime shuma e mjeteve financiare prej: 779,654.24€, për shpenzime të komunalive shuma e mjeteve financiare prej: 133,291.71€, për subvencione dhe transfere shuma e mjeteve financiare prej: 547,793.60€ dhe për investime kapitale shuma e mjeteve financiare prej: 1,231,195.93€. Përqindja e pjesëmarrjes në buxhetin e alokuar është %, të hyrat vetjake 0.29%, deri tani janë shpenzuar 10 milion euro, prej tyre 5 milion për paga dhe mëditje, 2 milion euro për mallra dhe shërbime dhe 350 mijë euro për komunal, ndërsa të hyrat vetjake janë grumbulluar 65.02%.

**Durim Hajra:** Tani të dhënat për raportin financiar të shpenzimeve janë të përmbledhura, në të janë bërë shpenzime të panevojshme, tani ne kërkojmë sqarime për shpenzimet në shumën e mjeteve financiare prej pesë mijë euro për shtesat tranzitore, pastaj kompensimet jashtë vendit, për

cilat raste janë përdorë mjetet financiare, edhe nga kodi i programit të Zyrës së Kuvendit të Komunës, pastaj janë shpenzimet e anëtarësimit, duam ta dijm ku jemi anëtarësuar ne si komunë, shpenzimet për gjeneratorë dhe makinerinë e komunës janë në shumë prej 41,000.00€, tani kur shpenzimet janë të grumbulluara, ato nuk dihen keqëpërdoren, ne nuk kemi sqarime për cilin produkt janë shpenzuar, shpenzimet për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve janë shqetësuese dhe të shumta, ato grumbullohet nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit por shuma e tyre arrin në 13,000.00€ në total, pastaj për përfaqësimin brenda vendit është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 27,000.00€, për qiranë e automjeteve janë shpenzuar 7,300.00€, për vendimet gjyqësore janë shpenzuar 24,000.00€ jashtë kontratës kolektive, mua më kujtohet si sot, kur u kam thënë se për shpenzime të tilla, nga ana e Auditimit të Jashtëm, do të jepen vërejtje për keqëklasifikim të shpenzimeve, pastaj për ndërtesat në arsim, rrethojat dhe mirëmbajtja e tyre janë shpenzuar 55,000.00€, shuma e mjeteve financiare prej: 9,000.00€ është shpenzuar për telefonat mobil, për qiranë e tokës janë shpenzuar 6,000.00€, për shërbimet kontraktuese tjera është shpenzuar një shumë bukur e lartë e mjeteve financiare, që e arrin shumën prej: 300,000.00€, subvencionet për entitete jo publike arrin shumën prej: 184,000.00€, ndërsa përfituesit individual nga subvencionet e arrin shumën prej: 534,000.00€, pastaj kemi shumë shpenzime të pa zbrërthyer në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve, ku ato nuk definoohen asnjëherë qartë, nuk sqarohen nga ana e Ekzekutivit të Komunës, as për neve si anëtarë të Kuvendit të Komunës, këto shpenzime duhet të jenë të qarta, sepse kemi të bëjmë me paranë publike që janë taksa të qytetarëve, por tani po vjen koha dhe ju do ta merrni ndëshkimin nga ana e qytetarëve. Unë personalisht mendoi se shumë shpenzime këtu nuk janë të dhëna drejtë nëpër kode ekonomike, sepse kemi një grumbullim të shërbimeve që ofrohen.

**Mirsad Qyqalla:** Për shumë të dhëna lidhur me shpenzimet në gjashtëmujorin e parë, ne kemi marrë disa sqarime edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, këtu shpenzime janë të grumbulluara nëpër kode ekonomike sipas rregullave financiare, por janë të pamjaftueshme për ne si anëtarë të Kuvendit të Komunës. Nga këto shënime shihet se shpenzimet për karburante dhe makineri të komunës, gjeneratorë e tjera janë të grumbulluara në një kodë ekonomike sipas përshkrimit, këtu mungon qasja praktike për zbrërthimin e tyre, andaj ne nuk dalim mirë edhe në raportin e transparencës, ne duhet ta kemi si synim përmirësimin e raportimit financiarë, sepse kemi të bëjmë me paranë publike dhe taksat e qytetarëve, ndaj të cilëve duhet të jemi llogaridhënës.

**Hasan Ismajli:** Unë dua t'i them Drejtorit të Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, kështu duhet me punuar dhe me ruajtur buxhetin sepse nga 2,000.00€, sa i keni pas shpenzime viteve tjera, keni rënë tani në 400.00€. Unë kam kërkuar me shkrim me datën 14.05.2024, të gjitha veturat e zyrtarëve të komunës, duke përfshirë Shëndetësinë, Arsimin dhe Qendrën për Punë Sociale me mi dhënë shpenzimet e harxhuar dhe për katër muaj, nuk më kanë kthyer përgjigje dhe unë po bindem, se diçka këtu nuk është në rregull.

**Shpend Bardiqi:** Unë insisto që Drejtori i Financave dhe Buxhetit nuk duhet me u paguar, sepse as për raportin e tyre të shpenzimeve nuk janë këtu, se di çka ka ma të rëndësishme se ky raport, tek ky raporti që e keni sjellë se pari pyes, a është ndërruar vetura e Kryetarit të Komunës, nëse po ai prapë ka paguar për mirëmbajtje 1,285.00€, ndërsa veturën tjetër e kemi paguar vite me radhë, nga 6,000.00€ në vitë. Ky i riu, a ka ardhur me garancion dua ta di, pse keni paguar nëse ka garancion. Unë kam propozuar më herët që të ndërrohet vetura e Kryetarit të Komunës, mirëpo atëherë keni thënë se janë dy vetura e tani po thuani se janë pesë vetura. Tek Zyra e Kuvendit të

Komunës në Fushë-Kosovë, asnjë cent nuk është i harxhuar dhe këta nga një veturë në zyre dhe po harxhojnë më shumë se ne të gjithë. Shumë interesante Drejtori për Inspektorat ka harxhuar më së pakti derivate, e cila drejtori duhet të inspektoj në qytet vazhdimisht, ka më së paku harxhime se drejtoritë e tjera.

**Vlonjat Hasani:** Dua t' i parashtroj disa pyetje zyrtarëve të cilët e kanë dorëzuar në shqyrtim këtë raport financiar të shpenzimeve. Ne po e dim se janë ndarë 30,000.00€ për digjitalizimin e sallës së Kuvendit të Komunës, por ne jemi duke e parë se kësaj rruge nuk e kanë ndërmend me shpenzuar, te zgjerimi i ngastrës kadastrale të varrezave në fshatin 'Miradi të Epërme', e diskutuam edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, që ai kod tani më është larguar krejt, këtu janë mashtruar disa persona dhe nuk po dua me specifikuar, se cila kategori është mashtruar, sepse këtu janë ndarë 40,000.00€, pastaj është larguar komplet kodi. Kam një pyetje dhe kisha dashur të marrë përgjigje menjëherë, në mënyrë që të vazhdoi, po e them me shifër në mënyrë që ju ta gjeni me lehtë, 54598 Palestra e Sporteve të Notit - faza e dytë në 'Miradi të Epërme', janë ndarë 100,000.00€, a është gabim apo çka, sepse asnjëherë nuk është ndarë kjo shumë e mjeteve për fshatin 'Miradi e Epërme'.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Unë kam qenë në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit dhe e kam marrë sçarimin lidhur me shpenzimet e z. Fehmi Gashi, që është punëtorë në kuadër të Projektit të Caritas Kosova dhe është paguar me shumën e mjeteve financiare prej: 3,000.00€, për vizitën në Kroaci, ndërsa ne nuk kemi mundur ta paguajmë kur kemi qenë në Shqipëri me anëtarët e Kuvendit të Komunës z. Sabri Raqi, që ka qenë si shofer me ne, po ashtu edhe zotëriu në fjalë është punëtorë në Projektin e Caritas Kosova, zbatimi i këtyre standardeve të ndryshme nuk është në rregull fare.

**Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet:** Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Palestra e sporteve faza e dytë në fshatin 'Miradi të Epërme', ky projekt është votuar në Kuvendin e Komunës, ne e shikojmë por kjo mirëet prej sistemit të 'Free - Balancit' dhe unë nuk mundem me ndryshuar, i nderuar pasi të përfundon mbledhja mundeni me ardhur në zyre dhe me verifikuar.

**Vlonjat Hasani:** Unë dua të ju ndihmoj të gjithëve, kur është marrë vendimi për Palestrën Sporteve të Notit - faza e dytë në fshatin 'Miradi e Epërme', në fillim ka shkruar për 'Miradi të Epërme' sepse kështu na ka ardhur në Kuvendin e Komunës, ju na keni thënë se këtu është një gabim teknik, sepse ky projekt është për fshatin 'Miradi e Poshtme', pastaj pyetem si po votohet na u tha, sot do të votohet për 'Miradi e Poshtme', sepse është gabim teknik, tani po del se ju nuk i përmirësoni gabimet, keni gabuar vendbanimin, kjo nuk është në rregull, ne po flasim me fakte të juaja që vetë i vendosni në tabelat e buxhetit.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Unë kam bërë një pyetje në Komitetin për Politikë dhe Financa, pyetja ka qenë, a duhet mu paguar nga buxheti i Kuvendit të Komunës z. Fehmi Gashi, i cili është me Projektin e Karitasit dhe nuk ka të bëjë me Kuvendin fare? Ky Kuvend ka pasur problem herën e kaluar, kur kemi qenë në Shqipëri, me Sabriun i cili ka qenë me Karitas sa i përket pagesës dhe kemi ndarë një pjesë nga parat tona, sepse na është thënë, se nuk mundemi me i' a mbuluar shpenzimet, për arsye se ai është me projekt dhe nëse ati nuk kemi mundur me i' a mbuluar shpenzimet, si po mundemi me i mbuluar shpenzimet për z. Fehmi Gashin dhe z. Bashkim Krasniqi në Kroaci, të cilët kanë shpenzuar shumën prej 3,000.00€.

**Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet:** Pyetja e parë për shtesat tranzitore, me Ligjin e Pagave disa zyrtarëve Komunal i'u është ulur paga dhe nga ana e Peirollit çdo muaj i bëhet rimbursimi i diferencës dhe kjo quhet shtesë tranzitore. Pyetja e dytë për kodin 13480 asocacioni, në këtë kodë është pagesa prej 5,224.00€, pagesa për Asociacionin e Komunave të Kosovës, kodi 13780 derivatet, me planin kontabël të ri, i cili ka ardhur në janar të vitit 2024, prej nivelit qendror dhe as një lëvizje nuk mundemi me bërë, se në fund të muajit kemi me u barazuar me Thesarin dhe për këtë arsye nuk janë të ndara, përpara kanë qenë të ndara, sepse nuk ka qenë ky emërtim. Unë nuk jam e gatshme me dhënë përgjigje politike, unë jam e gatshme me dhënë përgjigje profesionale. Planifikimi i buxhetit qysh të vjen, unë nuk mundem me ndërhyrë askund.

**Hasan Ismaili:** Më intereson ta di shpenzimet, të cilat i kanë bërë z. Bashkim Krasniqi dhe z. Fehmi Gashi si janë paguar? Unë kërkoj edhe nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, sepse ata janë paguar nga Kuvendi, a kanë ftësë që kanë shkuar si zyrtarë të Kuvendit apo si komunitet dhe pse me u paguar me buxhet të Zyrës së Kuvendit të Komunës.

**Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet:** Tani z. Fehmi Gashi ka shkuar si komunitet, sepse z. Fehmi Gashi është në listën e pagave tek Komiteti për Komunitete.

**Hasan Ismajli:** Nuk është zyrtarë, sepse në Komitetin për Komunitete është si përfaqësues i qytetarëve.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Sa i përket 'Raportit financiarë për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmuorin e parë të vitit 2024', kjo pikë nuk votohet vetëm shqyrtohet dhe analizohet, të gjitha shpenzimet e realizuara i keni në raportin financiarë.

#### **Pika shtatë (7) - Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2023.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Raportin e Auditimit të Jashtëm për vitin 2023'. Hap diskutimin.

**Laureat Gojnovci:** Ne si Grup Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kemi vendos mos me u marrë me këtë raport të auditorit, sepse është i motivuar politikisht, kur baza kryesore për opinion të cilin e ka dhënë auditori, ka qenë klasifikimi i një vlere prej: 800,000.00€ dhe ne jemi dëshmitarë se si janë shpenzuar ato para dhe si janë marrë nga vetë niveli qendrorë, kështu që as Kryetari i Komunës nuk e ka nënshkruar dhe ne nuk duam që as ne të diskutojmë.

**Habib Mekolli:** Vitin e kaluar ne e dimë se çfarë opinionin ka qenë, ku dihet se është opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare, keq klasifikimi i shpenzimeve prej: 800,000.00€, është e vërtetë se një pjesë e tyre janë për arsyeje të vendim marrjes së më hershme, të qeverive të tjera për kontratën kolektive që u a kanë lënë dhe një pjesë e madhe e mjeteve financiare shkojnë për këtë, por për veç këtyre janë edhe 170,000.00€ tjera që nuk janë në kuadër të kontratës kolektive, në këtë raport janë vetëm 20 rekomandime, prej të cilave 7 janë të reja dhe 13 tjera janë të përsëritura. Vitin e kaluar kanë qenë 14 rekomandime, një rekomandim është marr parasysh dhe është përmirësuar, ndërsa 13 tjera vazhdojnë edhe këtë vitë, me këtë mundet mos me u pajtuar Kryetari i Komunës apo Ekzekutivi i Komunës, mirë po nuk besoj që është kjo reale! Nga të gjitha çështjet unë isha ndalur vetëm tek një, që është ma problematike dhe ku ne kemi shprehur disa dyshime, që kanë qenë tek disa kamera të cilat janë vendosur në qytet, sepse shuma e tenderit tek ky projekt ka qenë shumë e madhe rreth 500,000.00€, si dhe përfituesit është i dyshimtë, që kanë qenë të afërt me këtë Ekzekutiv të Komunës, krejt këtë po na dëshmon edhe raporti i auditorit të

jashtëm për këtë vitë i cili ka gjetur që prej dy operatorëve që kanë qenë përfitues të këtij tenderi, operatori i parë nuk ka qenë i pajisur me licencat të cilat parashihen në ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, në raport thuhet se ka qenë vlerësim jo korrektë nga ana e komisionit vlerësues, ndërsa tek ne janë dyshimet që ka diçka jo të ligjshme, kështu që ne presim nga prokuroria apo krimet ekonomike që të hetojnë këtë rastë, sepse dyshimet vetëm sa na i ka forcuar ky raport i auditimit.

**Hasan Ismajli:** Tek raporti i auditorit është shqetësuese, sepse këtu ka vërejtje tek auditori i brendshëm, se si Kryetari i Komunës formon komision, e suspendon auditorin e brendshëm, i cili i ka me audituar asetet e komunës, projektet, pronat, kontratat dhe pagën e ka menjëherë pas Kryetarit të Komunës dhe kjo është shqetësuese. Tjetra çka është shqetësuese edhe më shumë është se një Kryetarë Komune i urdhëron të gjithë drejtorët e drejtorive, shefat dhe zyrtarët që auditorit të brendshëm, mos t'i përgjigjen në asnjë kërkesë dhe asnjë dokument të cilin ai e kërkon, po ashtu një pjese ju thotë mos rri me të. Auditori i brendshëm është autoritet, e ka detyrën e vetë dhe nëse gjen keqpërdorime e ka për detyrë me i dërguar në prokurori. Ne duhet me reaguar sepse kjo është shumë shqetësuese, është raporti më i dobët, që i ka ardhur këtij Ekzekutivi të Komunës, sepse në vitet e mëhershme, e kanë pasur Nënkryetarin e Komunës aty dhe ka ndërhy nga pak, tani nuk është aty dhe ka ardhur kështu. Auditorit të brendshëm nuk i flet askush, nuk rrinë askush me të, nuk i japin qasje në asnjë dokument që ai e kërkon. Me ju thënë të drejtë z. Laureat Gojnovci dhe z. Krenar Dumani edhe një pjesë këtu nuk guxon të rri as me mua. Unë e ngrita vetëm si shqetësim këtë çështje, mos me të folë një kolegë i opozitës, unë shqetësona dhe interesohem pse ai kolegë nuk po më folë, ose pse e ka të ndaluar me ndjetë me mua.

**Mirsad Qyqalla:** Me qenë se jemi të pika e Raportit të Auditimit të Jashtëm për vitin 2023, unë kisha pasur dëshirë që të ishte dikush që të paketën për pyetjet të cilat ne i parashitrojmë të marrim përgjigje. Unë dua ta di se kush është peroni përgjegjës të cilit duhet t'i drejtohem që minimalisht t'i marrim disa përgjigje, unë këtë shqetësim e kam ngritur edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Nëse ky Raport ka ardhur vetëm si dokument në Kuvend atëherë pse ta diskutojmë ne, sepse gjetjet janë te auditorit dhe për sqarime të cilat, ne kemi nevojë me i marrë, ne nuk kemi kujt t'i drejtohem, a është dikush nga Ekzekutivi i Komunës, që është i deleguar nga ana e Kryetarit të komunës përgjegjësia, që të përgjigjet për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk ka atëherë, unë nuk kam çka të diskutoi në lidhje me këtë pikë.

**Durim Hajra:** Opinioni i auditorit të jashtëm tregon se pjesërisht qysh është gjendja me pasqyrat financiare në Komunën e Fushë Kosovës, përfaqësuesi i mazhorancës tha që nuk duam të diskutojmë për këtë raport të auditimit dhe besoj që kjo është çështja ma serioze për diskutim, sepse realisht ne po e shpërfaqëm një hipokrizi, se nëse një raport i auditorit gjeneral ka qenë i pranueshëm para disa viteve, sepse Nënkryetari i Komunës e ka përgatit këtë raport pse tani ky raport nuk është i pranueshëm, e atëherë po. E dyta disa kolegë të mi kanë thënë që Raporti i Auditorit në bazë të asaj që ne e dimë, nuk duhet me qenë ky, sepse ne e dimë që gjendja është edhe ma keqe. Kur ne e kemi thënë se ky raport ka lidhje me Ekzekutivin e Komunës, neve na është thënë që nuk ka lidhje por tani po dihet se ka pasur ndikime nga auditimi dhe atëherë ky argument nuk është marr për bazë. I nderuar kolegë z. Laureat Gojnovci po ju drejtohem juve pasi që ju jeni Shef i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nëse për juve nuk është bazë e mjaftueshme opinioni i kualifikuar, a kini pra ndonjë të dhënë me ndonjë argumentim të kundërtë. Ju deklaruat diçka që nuk qëndron. Nëse nuk është e mjaftueshme ajo bazë të cilën e ka

marr auditori gjeneral, a mjaftojnë këto që u folën në raport me shpenzimet pak ma herët, ju po i keqë klasifikoni shpenzimet, e para thotë keqë klasifikimi i shpenzimeve në kategorinë ekonomike në vlerë prej 818,000.00€, prezantimi jo i plotë dhe jo i sakët i pasurive në pasqyrat vjetore financiare për arsye të nënvlerësimit 428,000.00€ dikujt i duket e paktë kjo është mostër, sepse asnjë auditor nuk i merrë komplet pasqyrat financiare me i audituar, prezantimi jo i plotë dhe jo i sakët i detyrimeve kontigjente në vlerë prej 244,000.00€, prezantimi jo i plotë dhe jo i sakët i llogarive të arkëtueshme. Nëse këto çështje nuk janë për të ndikuar në opinion atëherë, është mirë me dal dhe me na treguar. Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, mos regjistrimi i pasurive, prezantimi jo i plotë, përzgjedhja e operatorëve të pa përgjegjshëm, pagesa nga buxheti i projekteve tjera dhe një çka është shumë e rëndësishme një kontratë që i'u është dhënë një operatori, që ka të bëjë me kamerat e sigurisë, e që e tha edhe parafolësi, ka shkelje të rënda, sepse nuk mundet me i marrë një milion e dy qind euro tender, duke e anashkaluar operatorin e dytë dhe të tretin të cilët e kanë licencën. Kjo ka ndodhur rastësisht me qenë shokë i Nënkrjetarit të Komunës, është mirë me dal dhe me pranuar kur nuk e bënë punën, ashtu siç duhet, është njerëzore, auditori ju e dini se në fund ka me dhënë nënshkrim.

**Fisnik Sllamniku:** Sa i përket raportit të auditimit, shumica prej neve i kanë parë gjetjet e auditorit, Zyrtarët jashtë listave të pagave, ne vet kemi ndarë buxhet për këta punonjës dhe këtu ka dhënë edhe vërejtje auditori. Pyes, se çka kishtë ndodhur, me pjesën e arsimit në qoftë se nuk i kishim marrë këta 42 punonjës jashtë listave të pagave, ne e kemi ditur se janë jashtë listave të pagave dhe mundet me na dhënë vërejtje auditori, mirëpo ndoshta më mirë, me na dhënë vërejtje, se sa me mbetë keq arsimi. Ne e dimë se arsimi, shëndetësia dhe administrata, për shkak të kontratës kolektive, këto shpenzime përmbarimore janë zakonisht të mëdhaja. Unë mendoi se nuk është një fajësim i komunës për këto pika, për arsye se jemi munduar me bërë zgjidhjen më të mirë të duhur sa i përket procesit mësimorë.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunës:** Meqë kjo pikë e rendit të ditës nuk votohet, kalojmë në pikën e radhës për shqyrtim.

#### **Pika e tetë (8) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Ftoj Drejtorin e Administratës i cili është edhe Kryesuesi i Grupit të kësaj rregulloreje, që të na jap sqarime.

**Drejtori i Administratës:** Përshëndetje i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës dhe të gjithë ju të pranishmit në mbledhje, keni pranuar materialin e 'Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale'. Grupi punues në bashkëpunim me ekspertin e jashtëm, ka hartuar rregulloren, e cila ka ardhur në lexim të parë, kjo rregullore parasheh sistematizimin e vendeve të punës të komplet administratës komunale. Ku kemi kompletuar përshkrimin e detyra të punës për secilën drejtori. Këtu parashihet të jenë 15 drejtori, me 276 punëtorë. Bashkangjitur kemi shtojcën numër një dhe organo gramini si shtojcë numër dy. Kjo rregullore është në lexim të parë, kalon në dëgjime publike dhe pastaj vjen në shqyrtim të dytë. Në emër timin si kryesues i këtij Grupi i falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë.

**Habib Mekolli:** E falënderoj, Drejtorin e Administratës për sqarimet, unë dua ta di pse ne, nuk jemi të përfshirë në këtë rregullore, pasi që çdo herë kemi marrë pjesë anëtarët e Kuvendit të



Komunës. Ne e pamë se një ekspert e kish përgatit këtë rregullore kishte qenë mirë, ai me qenë sot këtu dhe me na u prezantua, edhe nëse është super ekspert kishte qenë mirë me ardhur, edhe në rregulloret e tjera, jo vetëm në këtë. Komuna jonë ka 5000 mijë persona me nevoja të veçanta, me ligj është në 50 punëtorë një person me nevoja të veçanta, unë mesa e di në komunën tonë është vetëm një, unë në dëgjime publike, propozoj që të shikohet tek personat me nevoja të veçanta.

**Mirsad Qyqalla:** Qëndrimi mbetet njëjtë si në Komitetin për Politikë dhe Financa, në këtë rregullore ne si anëtar të Kuvendit të Komunës, nuk kemi qenë të përfshirë dhe nuk i dijm arsyet pse duhet me u rrit drejtoritë. Ne si Grup Parlamentarë i Partisë Demokratike të Kosovës jemi kundër kësaj rregullore.

**Hasan Ismajli:** Dua të parashtoj një pyetje Drejtorit të Administratës, meqenëse ke qenë Kryesues i Grupit të kësaj rregulloreje dhe e keni ditur se kjo rregullore vjen në Kuvendin e Komunës në lexim të parë dhe të dytë, dua ta di arsyen pse nuk ka qenë prezentë së paku Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në përgatitjen e kësaj rregulloreje dhe Kryesuesi i Kuvendit me një takim, pastaj është dashur Shefave të Grupeve Parlamentare të u'a tregoj se çka ka është diskutuar në atë takim dhe a ka pasur favore, sepse aty dikush ish favorizuar, e dikush jo. Nuk ka pasur asgjë të keqe, nëse kishte qenë pjesëmarrës së paku Kryesuesi i Kuvendit, sepse ajo po vjen në Kuvend për ta votuar. Në këtë punë kanë marrë pjesë edhe me Karitas dhe anashkalohet organi më i lartë që ka me kaluar me votën e tij dhe Kryesuesi i Kuvendit. Pyes, a është e ndaluar me ligje që Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të marrë pjesë në këtë rregullore.

**Vlonjat Hasani:** Në Komitetin për Politikë dhe Financa, e diskutuam këtë pikë të rendit të ditës, anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk janë në këtë Grup Punues dhe ne nuk i dimë kush kanë qenë anëtarët e këtij Grupi Punues për hartimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, për hartim të rregulloreve, ne e dimë se kanë me u mbajtur dëgjime publike, çka dimë ne saktësisht është, se ju e keni marrë një ekspert për hartimin e kësaj rregulloreje dhe e dimë që ky ekspertë, e ka marrë një shumë prej 7,500.00€, për këtë rregullore. Ne kemi hyrë dhe kemi hulumtuar për ekspertin dhe ky del se është i së njëjtit subjekt të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kjo është publike dhe është diçka që shihet, ky ekspert është paguar prej Komunës së Fushë-Kosovës, prej taksave të qytetarëve të komunës, prej subjektit të tij dhe vjen e gatshme, si dhe kërkohet vota jonë për miratim. Ne nuk e mbështesim miratimin e kësaj rregullore.

**Drejtori i Administratës:** Ju kisha lutur ta shqyrtoni dhe nëse keni ndonjë vërejtje përmbajtësore siç e tha z. Habib Mekolli për Zyrtarin me nevoja të veçanta, të jepni vërejtje gjatë procedurës. Kjo është rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale dhe Shef i të gjithëve është Kryetari i Komunës dhe ka praktika, edhe nga komunat tjera, të cilat nuk e kanë kaluar me rregullore fare, por e kanë kaluar me vendim të Kryetarit të Komunës, sepse mundet edhe në atë formë me shkuar, mirëpo në këtë pikë Statuti i Komunës, e parasheh që Administrata rregullohet përmes rregullores. Kjo rregullore i shfuqizon dy rregullore tjera që janë në fuqi dhe hyn në fuqi rregullorja e re, eksperti i jashtëm e ka asistuar Grupin Punues në mënyrë që të jetë në harmoni të plotë me dy akte ligjore dhe dy akte tjera nënligjore si vijon: Ligjin për Zyrtar Publik dhe Ligjin për Pagat e Sektorit Publik, me rregulloren 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës dhe me katalogun e vendeve të punës. Eksperti ka edhe detyra tjera në para masën dhe specifikat e punës së tij, të cilat janë publike në prokurim. Nuk e kam ftuar ekspertin, sepse nuk e kam parë të nevojshme, sepse unë jam Kryesues i këtij Grupi Punues.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim në shqyrtimin e parë dhe kalimin e saj në procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', nëntë vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovon në parim në shqyrtimin e parë dhe kalimin e saj në procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale'.
2. Projekt - Rregullorja për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën e Komunës së Fushë-Kosovës', parasheh mënyrën e organizimit dhe rregullimin e brendshëm, përgjegjësit e njësive organizative si dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale, përfshirë administratën e shërbimit publik dhe organogramin e komunës.

#### **Pika nëntë (9) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Ftoj dikën nga Drejtoria e Arsimit të na elaboroi në shqyrtimin e parë të 'Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026'.

**Fisnik Sllamniku:** Para nesh e kemi një planë të veprimit, kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës, ky plan quhet Ekipi për Parandalim dhe Braktisje, është në kuadër të shkollave ku secila shkollë e ka ekipin për parandalim dhe braktisje në kuadër të shkollave, është edhe ekipi i nivelit komunal. Gjatë viteve të kaluara e kemi parë, që ky ekip është i rregulluar edhe me ligje dhe me udhëzim administrativ, detyrë e këtij ekipi është përfshirja e komunitetit në shkolla. Këto ekipe të cilat kanë shërbyer edhe në të kaluarën, kanë funksionuar shumë mirë dhe kanë ulur numrin e nxënësve të cilët e braktisin shkollën, ky ekip përveç braktisjes që është mirë, merret edhe me ata të cilët nuk i dërgojnë fëmijët në shkolla.

**Vlonjat Hasani:** Fatëkeqësisht nuk i kemi zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit dhe këtu po shihet sa është serioz ky plan. Në Komitetin për Politikë dhe Financa ka qenë një zyrtarë, e cila e ka elaboruar këtë plan dhe na ka thënë, se ne nuk e dimë ku shkojnë nxënësit, pas tre muajve ata largohen pa informim se ku kanë kaluar, nëse një nxënës e ndërron vendbanimin ose e ndërron shkollën e merre një vërtetim prej shkollave që po largohet, i tërheq dokumentat prej asaj shkolle, shkon në shkollën tjetër dhe nuk lajmërohet se ku është duke e vijuar mësimin ai nxënës, këta nxënës njihen si nxënës të cilët e kanë braktisur shkollën. Sipas raportit që na ka ardhur nga Drejtoria e Arsimit, na kanë thënë që këtu ka ekipe profesionale por Drejtoria e Arsimit kemi dështuar në këtë proces vet kanë thënë .

**Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete:** Sqaroi se këtu duhet të jemi korrekt, sepse zyrtarja e arsimit, e ka elaboru edhe fletëkthimin dhe fletëlargimin që zgjatë tre muaj, po ashtu ka thënë që është mungesa e një sistemi elektronik si databazë, të cilin e ka kërkuar prej Ministrisë së Arsimit, ku duhet me u vendos braktisja e numrit të nxënësve, mirëpo ata e kanë përkrahur vetëm gojarisht.

**Aida Alimi:** Pasi që, ky plan është në shqyrtim të parë, ne e inkurojmë Grupin Punuës për punën e realizuar dhe ne do të mundohemi të kontribuojmë, me aq sa kemi mundësi.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim në shqyrtimin e parë dhe kalimin e tij në procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 – 2026' U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe dy abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi në parim në shqyrtimin e parë dhe kalimin e tij në procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026, në të gjitha shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026, në të gjitha shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës, parasheh zhvillimin e punëve dhe aktivitetëve për parandalimin e braktisjes së shkollës.
3. Pjesë përbërëse e 'Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026'.

**Pika e dhjetë (10) - Propozim për shpalljen me interes publik dhe fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e objektit të Xhamisë në Fushë-Kosovë.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Ftoj Drejtorin e Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, që të na sqaron 'Propozimin për shpalljen me interes publik dhe fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e objektit të Xhamisë në Fushë-Kosovë'.

**Drejtori i Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës:** Përshëndetje për të gjithë. Para jush keni një propozim prej Kryetarit të Komunës i adresuar tek anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës, ky propozim ka të bëjë me shpalljen me interes publik me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, për ndërtimin e xhamisë, ngastra kadastrale është me numër 01375-0, në Zona Kadastrale Fushë-Kosovë, ku do jepet një pjesë e ngastrës për shfrytëzim afatgjatë, komplet ngastra ka sipërfaqe prej 2742 metra, ndërsa në shfrytëzim do të jepen 1830 metra, periudha me të cilën do jepet në shfrytëzim do të jetë periudhë afatgjatë prej 99 viteve. Sa i përket ndarjes, ne nuk i kemi ndarë për arsye, se së pari duhet të merret një vendim nga Kuvendi i Komunës, e pastaj të vazhdojmë me procedurat tjera.

**Hasan Ismajli:** Unë mendoj se Drejtori i Kadastrit nuk ke i saktë në prezantimin e tij, i cili tha fleta poseduese 01375-0, mirëpo nuk e tregoi kopjen e planit dhe unë para se të hy në temë, dua ta

pyes Drejtorin e Urbanizmit, a lëshon leje ndërtimor nëse fleta poseduese dhe kopja e planit nuk përputhen në mes veti, e cila ndryshon me shifër dhe metër katror, sepse sipas Drejtorit të Kadastrit nuk është me rëndësi, sepse e kemi fletën poseduese. Unë nuk kërkoja rastësisht që fleta poseduese dhe kopja e planit të jetë e vulosur dhe nënshkruar nga zyrtarët të cilët e kanë lëshuar këtë. Kolegë të nderuar për sqarim kjo pronë, para disa muajve apo një viti, unë e kam thënë në këtë foltore dhe ua kam dërguar edhe Shefave të Grupeve Parlamentare, ku kanë qenë z. Remzi Shala, z. Durim Hajra dhe z. Mirsad Qyqalla dhe auditori i cili e ka audituar dhe ka gjetur se ka ndërhyrje në këtë ngastër dhe kjo pronë është në prokurori. Unë kam bërë kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit, i inspiruar nga kërkesa e z. Tërnavës, i cili thotë në vazhdën e hulumtimeve, sepse në këtë raste Kryesia e Bashkësisë Islame pa koordinim me Këshillin e Bashkësinë Islame në Fushë-Kosovë, nuk kanë koordinim njëri me tjetrin, do të thotë se kjo ka ardhur direkt prej z. Tërnavës, thotë në vazhdën e hulumtimeve dhe analizave të bëra me Drejtorin e Urbanizmit, kemi identifikuar disa ngastra, të cilat janë pronë publike, unë kam bërë kërkesë zyrtare në Drejtorinë e Urbanizmit dhe kam kërkuar me hartë zonale çka parashihet në këtë ngastër dhe e kam marrë përgjigjen zyrtare prej Drejtorit të Urbanizmit dhe Shefes së Urbanizmit zona ZSH 6-215 me destinim institucion shkollorë. Unë nuk jam kundër xhamisë, por problemi im është tek prona, kjo pronë me fletë poseduese i ka 27 ari e 42 metra, kopja e planit është 18 ari e 29 metra, sepse këtu ka ndërhyrje, vazhdimi i mbetjes së kësaj prone, kolegë të nderuar kështu ka qenë prona, sepse deri tek 'Boshi' 1375/0 i ka 27 ari e 42 metra, me ndërhyrje që ju ka dhënë prona në mes të këtyre dyjave, janë 2 ari e 32 metra ngastër me Nr. 1372/1, kjo ngastër është e një privati, i cili ka një biznes, për ta vërtetuar drejtor në lëndët e tua e gjen kur ju ka lëshuar këtij privati leja ndërtimore, ju ka lëshuar me 7 ari 68 metra, sepse ashtu i ka pasur dhe ky tani le të na dokumenton me këtë numër, sa ari i dalin privatit, sepse unë e di se i dalin 10 ari. Unë e di se kur të lëshohet leja ndërtimore për këtë, atë leje ndërtimore keni me lëshuar ju, e jo zyrtarët e drejtorisë suaj, sepse e dinë që e shkelin ligjin. Në këtë pronë ka ndërhyrje prej 2 ari e 32 metra, që ju ka fal dikujt apo ju ka dhënë, kjo është në gjykatë dhe nëse doni me votuar, votoni. Për të ju treguar se kjo është puro-politike, mes tre apo katër personave dhe unë kam bërë kërkesë në Këshillin e Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë dhe ata mu kanë përgjigje se nuk janë në dijeni për këtë punë dhe nuk marrin pjesë në këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Kjo nuk është kërkesë e Këshillit Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës, por e qendrës, sepse Bashkësia Islame i'a kanë kthyer një përgjigje të cilët kanë thënë ne nuk marrim pjesë në këtë, sepse nuk na kanë pyetur.

**Laureat Gojnovci:** Si çdo kërkesë tjetër edhe kjo kërkesë për ndërtimin e objektit, që buron nga kërkesa e nevojës të krijimit të një hapësire për xhami, kjo ka ardhur nga qendra Kryetarit të Komunës dhe tani Kryetari i Komunës ka shpreh gatishmëria që ta japë për shfrytëzim këtë tokë, e jona është që ta përkrahim ose jo. Ne si Grup Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim ndërsa për implementimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi është përgjegjës komuna, ne kemi me marrë vendim se a kemi me dhënë në shfrytëzim dhe nëse ka implikim gjatë rrugës për këtë procedurë, do të ndjekim rrugët ligjore.

**Durim Hajra:** Ne po diskutojmë tek përmbajtja e dokumentit, nëse bëjmë kërkesën në gjeo-portal, na del se nuk janë 27 ari. Ne tani a t'i besojmë gjeo-portalit apo dokumentacionit që na e keni dorëzuar apo me shkuar në teren dhe me parë gjendjen faktike. Ne jemi për nëse ju e bini vendimin se kanë me qenë 27 ari të cilët jepen në shfrytëzim dhe jo 18 ari sa janë prezantuar, për arsye se ky

zotëria është duke i shfrytëzuar jashtëligjshëm, ta ka uzurpuar pronën dhe nuk jeni duke mundur me i'a marrë, shtynë këtë pikë të rendit të ditës bone parcelizimin dhe ndarjen, nëse i'a keni falë qysh po supozon asambleisti, atëherë jep përgjegjësi penale ai që e ka falë, nëse e ka uzurpuar thuani lironi hapësirën, sepse kemi nevojë dhe sjellë me dokumentacion, ashtu siç duhet, sepse sipas dokumentacionit këtu interes publik nuk ka.

**Mirsad Qyqalla:** Një kritikë për Drejtorin e Kadastrit, i cili ka thënë që materialin e bijmë me ngjyra që të shihet më mirë, mirëpo nuk e ka pruar. Unë edhe në komitet e kam thënë, nëse është dashur mu ndjek një rrugë kishte qenë mirë që neve si përfaqësues të partive politike, me na takuar me Bashkësinë Islame dhe me biseduar dhe me pasur një votë unifikuese, që me na arsyetuar nevojën për një Xhami të re. Unë i pashë disa dokumente dhe është e vërtetë se fleta poseduese dhe kopja e planit nuk janë të njëjta. Drejtori na ka thënë, që ku është me zero, është që nuk është prek, ndërsa në kopje të planit është me një. Nëse një operator i ka 2 ari e 40 metra, dilema jonë është që mos me lejuar që në emër të Xhamisë me u mshef edhe do defekte kush do që i ka bërë. Ne si Grup Parlamentarë i Partisë Demokratike të Kosovës, jemi për Xhami çdo herë, por kemi nevojë për disa sqarime, sepse ne nuk duam që ta shkelim ligjin. Pyetja ime drejtor është, se në Hartë Zonale të Komunës figuron pronë për shkollë, ju si drejtori, a keni të drejtë prej shkollës ta bëni xhami, drejtor a na garantoni ju personalisht në momentin që fillojnë procedurat, ju keni me lëshuar leje ndërtimore, që ne që votojmë, mos jemi pjesë e dhënies në shfrytëzim të pronës për një objekti i cili nesër mundet me përfunduar pa dokumenta. Për Xhami jemi gjithë, por duam sqarime shtesë.

**Drejtori i Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës:** Tani z. Hasan Ismajli më tha se ju nuk dini asgjë, a mundeni me më treguar, se çka punoni ju, që po i dini të gjitha.

**Hasan Ismaili:** Aty çka kam folë jepi përgjegjësi, kjo lëndë ka shkuar prej auditorit në prokurori dhe javën tjetër këtë lëndë do ta çojë edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

**Drejtori i Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës:** Edhe unë jap përgjegjësi, bazë ligjore për caktimin e pronësisë është fleta poseduese dhe fleta poseduese e lëshon vetëm Drejtorja e Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës. Këtu keni datën kur është lëshuar, orën dhe në momentin që ju ka ardhur juve prej drejtorisë, nënkupton që është zyrtare, numrin e ka 1375/0, sa metra i ka, janë 2742, sa kemi mi dhënë 1830, kur të ndahet e shikojmë sa po mbesin. Ngastër kadastrale në veti është kjo. Një ngastër kadastrale e cila ka qenë me përfundimin 0, nënkupton që ajo ngastër nuk është prekur, kjo i ka 2742 metra, në momentin që ndahen krijohen njësi, ku 0 kalon në historiatë dhe vinë njësitë tjerat të cilat janë krijuar 1, 2, 3. Unë po ju them se kanë me u ndarë 18 ari e 30 metra, pjesa tjetër jetë në pronësi të komunës. Kryetari i Komunës ka propozuar me i dhënë në shfrytëzim 18 ari e 30 metra, ndërsa pjesa tjetër me u përdorë për qëllime tjera infrastrukturore.

**Drejtori për Planifikim Urban:** Në këtë fazë e kemi projektin konceptual, si arsyetim i qëllimit kemi të bëjmë me një Xhami të tipit, ashtu siç është ndërtuar në Lipjan, ndërsa në fazën e mëvonshme vjen projekti i strukturuar për ndërtimin e Xhamisë në bazë të së cilit do të lëshohet edhe leja për ndërtimin e Xhamisë, destinimi i dhënë për atë zonë, është zonë e shërbimeve, nën kodi i institucionit është shërbime që parasheh numrin e radhëve në blloqe. Në zonën e shërbimeve mund të jepet leje ndërtimore për shkollë, objekte sportive ose siç është rasti ynë objekti i Xhamisë, ne tani jemi në fazën finale të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal jemi para marrjes së pëlqimit, ju e dini diskutimet që i kemi pasur lidhur me rregulloren e bonuseve, ku për të ndërtuar një shkollë të re, në mungesë të pronës komunale, kemi dhënë bonuse për të siguruar sipërfaqen për ndërtimin

e shkollës, shpesh herë fleta poseduese nuk përputhet me ingjizimin gjeodezik brenda kufijve, ku ndërrojnë pozicionet, varësisht se a kemi bashkim apo ndarje të pronës në fjalë, për ne projekti konceptual paraqet një element bazë për fillimin e procedurës.

**Mirsad Qyqalla:** Sipas Hartës Zonale të Komunës aty destinimi është për shkollë, ndërsa aty parashihet të ndërtohet një Xhami, pyetja ime është, a është ky proces i kundërligjshëm?

**Drejtori për Planifikim Urban:** Unë e bëj zbatimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, në bazë të marrëveshjes që lidhet ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, njësoj edhe Xhamia në fshatin Sllatinë të Madhe është zonë e shërbimeve, andaj nuk paraqet ndonjë kërkesë sepse leja për shkollë dhe objekte të Xhamisë jepet njësoj sikurse për banimet kolektive.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunës:** Këtu kemi të bëjmë me një institucion publik dhe fillimin e procedurave sipas fletës poseduese.

**Hasan Ismajli:** Unë nuk po kërkoi nga këta me pranuar, sepse urdhërin ju ka dhënë, që të thuan kështu, për të qenë i saktë unë me ju, po kërkoi mirëkuptim prej juve që të premtën, unë të vijë dhe në ngastrën kadastrale 1372, të privatit të cilit ju kanë falë 2 ari e 29 metra, po e kërkoi fletën poseduese të këtij numri, nëse nuk i dalin 10 ari, unë nuk do të vijë më këtu dhe po kërkoi nga drejtori le të na i gjen lëndën, kur ju ka lëshuar leja ndërtimore, sepse ky zotëria e ka shtëpinë katër katëshe, dy kate i ka biznes dhe dy kate tjera banim dhe ju i'a keni lëshuar lejen ndërtimore në komunën e vjetër dhe e shikojmë në letër të kërkesës së tij kur ka aplikuar për leje ndërtimore, a ka aplikuar me 7 ari e 68 metra, nëse i dalin 10 ari, unë nuk do të vijë më. Hetuesi këtu duhet ta shqyrtoj dhe analizoj pjesën grafike e cila ka ndryshuar dhe nuk duhet të jetë shumë i mençur sepse këtë e paraqet fleta poseduese, në totalin e saj të sipërfaqes që ndryshon me gjendjen faktike në teren. Mbështetur në atë që e thash më lartë, unë nuk marrë pjesë në këtë votim.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Unë lidhur me këtë propozim, nuk do të marrë pjesë në votim, sepse mbështetur në nenin 38 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, unë punoj me honorar në Bashkësinë Islame të Kosovës.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozim për shpalljen me interes publik dhe fillimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e objektit të Xhamisë në Fushë-Kosovë'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim e aprovoi 'Propozimin për shpalljen me interes publik dhe fillimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e objektit të Xhamisë në Fushë-Kosovë' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 1047, të datës 02.09.2024 për shpalljen e interesit publik të ngastrës kadastrale Nr. P-72514036-01375-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, pronë komunale e Komunës së Fushë-Kosovës, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 14-942-25512, të datës 19.08.2024, me destinim për ndërtimin e objektit të Xhamisë në Fushë-Kosovë.
2. Prona Komunale e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, në lidhje me ngastrën kadastrale Nr. P-72514036-01375-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 14-942-25512, të datës 19.08.2024, jepet



në shfrytëzim afatgjatë për nëntë dhjetë e nëntë (99) vite, për Bashkësinë Islame të Kosovës, me destinim për ndërtimin e objektit të Xhamisë në Fushë-Kosovë.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim edhe 'Propozimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli për vendosjen e shtatores së Presidentit 'Ibrahim Rugova' në ngastrës kadastrale Nr. P-72514036-01375-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tre pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të anëtarëve pjesëmarrës në votim nuk e kalon 'Propozimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli për vendosjen e shtatores së Presidentit 'Ibrahim Rugova' në ngastrës kadastrale Nr. P-72514036-01375-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë'.

**Pika e njëmbëdhjetë (11) - Rishqyrtimi i vendimit Nr. 104, të datës 02.08.2024, sipas shkresës 020-7/10 të datës 15.08.2024.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Ky vendim është kthyer në rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me shkresën Nr. 020-7/10 të datës 15.08.2024, për arsye të ndryshimit të strukturës në barazisë gjinore në kuadër të përbërjes së Komitetit për Komunitete, mirëpo tani relacioni i përbërjes është pesë meshkuj dhe katër femra, me propozimin që anëtarë të rinjë të jenë: z. Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Komitetit Egjiptian dhe znj. Vjollca Konjusha - anëtare nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim dhe ndryshim 'Kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Nr. 104, të datës 02.08.2024, sipas shkresës 020-7/10 të datës 15.08.2024, me propozimin që anëtarë të rinjë të Komitetit për Komunitete të jenë: z. Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Komitetit Egjiptian dhe znj. Vjollca Konjusha - anëtare nga Lidhja Demokratike e Kosovës'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovon 'Kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Nr. 104, të datës 02.08.2024, sipas shkresës 020-7/10 të datës 15.08.2024, me propozimin që anëtarë të rinjë të Komitetit për Komunitete të jenë: z. Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Komitetit Egjiptian dhe znj. Vjollca Konjusha - anëtare nga Lidhja Demokratike e Kosovës' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për rishqyrtimin e vendimit Nr.104, të datës 02.08.2024 dhe ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7, të vendimit Nr. 200, të datës 29.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Komitetit Egjiptian, duke e larguar znj. Linda Hyseni nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e z. Bashkim Krasniqi në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Komunitete.
2. Me rishqyrtimin e vendimit Nr.104, të datës 02.08.2024 dhe ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 200, të datës 29.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike


të Kosovës, duke e larguar znj. Arjeta Jashari nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e znj. Vjollca Konjusha në cilësinë e anëtares së re të Komitetit për Komunitete.

**Pika e dymbëdhjetë (12) - Të ndryshme.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Tani jemi në pikën 'Të ndryshme', ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 17:00h.**

Procesmbajtës  
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Ali Ismaili

